

Kumbona e së Diellës



Jezus Krishti duke i dhënë çelësat e parajsës Shën Pjetrit - Peter Paul Rubens

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.5/6, Maj - Qershor 2022

DIOQEZA E MYNIHUT KREMTON DITËLINDJEN E 95-TË TË BENEDIKTIT XVI

Më 18 qershor Fondacioni Joseph Ratzinger organizoi një ceremoni festive për Papën e Nderit, Benedikti XVI, me rastin e ditëlindjes së tij të 95-të. Të pranishëm, Sekretari i Tij, Georg Gänswein dhe Nunci Apostolik në Gjermani, Kryeipeshkvi Nicola Eterović

R.SH. - Vatikan

Imzot Gänswein u përcolli urimin dhe bekimin e Papës së Nderit të ftuarve dhe atyre, që e ndoqën ceremoninë e transmetuar nga Mynihu në EWTN.TV, në manastirin Mater Ecclesia, në kopshtet e Vatikanit. Sekretari i Papës së Nderit kujtoi se as ai, e as Benedikti XVI, nuk patën menduar kurrë se Papa i nderit do të jetonte kaq gjatë pas dorëheqjes nga papnia, në vitin 2013. Shumë vite, madje edhe të trazuara, gjatë të cilave Papa gjerman i jetoi gjithnjë në paqe shpirtërore. Në atë paqe, që e shoqëroi ndër të gjitha epokat. “Vitet e fundit - vijoi jo pa keqardhje imzoti Gänswein - ia ligështuan forcat, por nuk munden t'ia prekin aspak humorin e tij të hollë, aq më pak, butësinë, tipar karakteristik i Papës gjerman”.

Ceremonia festive u hap me fjalën e mbajtur nga Marianne Schlosser, fituese e çmimit Ratzinger 2018, profesreshë e teologjisë në Universitetin e Vjenës. Ajo e quajti Papën Benedikti “Bari dhe Mësues”. Më pas vuri theksin mbi konceptimin ekleziologjik të teologjisë së kardinalit Ratzinger, sipas të cilit Kisha duhet të flasë të vërtetën në të gjitha kohërat, madje edhe sot. Kisha duhet të jetë “syri në trupin e njerëzimit” dhe të shikojë dritën. Jozef Ratzinger/Benedikti XVI e konsideron gjithnjë aftësinë e Kishës për të folur të vërtetën, si parakusht për dialog.

Nunci Apostolik në Berlin, Kryeipeshkvi Nikolla Eterović, nga ana e tij u drejtoi një mesazh mirëseardhjeje të pranishmëve. Kur ishte në Romë, gjatë gjithë kohës së papnisë së Benediktit XVI, diplomati pati kryer detyrën e sekretarit të përgjithshëm të sinodit të ipeshkvijve.

Benedikti XVI e festoi ditëlindjen e tij të 95-të më 16 prill, të Shtunën e Madhe. Fondacioni Joseph Ratzinger/Papa Benedikti XVI në Mynih, së bashku me Institutin Papa Benedikti XVI në Regensburg, ftuan në ceremoni ipeshkvin-ndihmës të Regensburgut, Imzot Josef Graf dhe ministrin Edmund Stoiber, politikan gjerman, për 14 vjet (1993-2007), President i Bavarisë si dhe shumë anëtarë të rrethit të nxënësve të kardinalit Ratzinger dhe të rretheve të reja të nxënësve.





Papa Françesku ZOTI VEPRON NË JETËN TONË	4
Dom Nosh Gjollaj KULTIVIMI I DURIMIT DHE I NJOHJES	5
Moter Marjeta Gjoka NJERIU SI PERSON E SI QENIE SHOQËRORE	8
Luigj Mila DITËT QËNDRESËS, 20 – 24 MAJ 2022	12
Imzot Angelo Massafra OFM NGA HISTORIA, E RRËFYER NGA GURËT	15
Dom Fation Mullarthy SHUGURIMI I DOM FATION MULLARTHI	16
Imzot Angelo Massafra OFM DITA E TOKËS	17
Dom Dritan Ndoci KISHA E RE NË MELGUSHË	20
Imzot Angelo Massafra OFM NDËRVEPRIMI DHE DIALOGU	21
Imzot Angelo Massafra OFM SHPREHIM BESIMIN DHE SHPRESËN TONË	21
Fra Lorenc Pepniku INAUGURIMI I KUMBONARES NË GIMAJ	22
Redaksia ATE DEDË GJOKA, O.F.M	24
Lekë Mrija PËR BASHKIMIN E TROJEVE	25
Frank Shkreli 60-VJETORI I LIDHJES KATOLIKE SHQIPTARO-AMERIKANE NË NJU JORK	29
Redaksia KISHA E KUVENDIT TË ARBRIT	31

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXV, nr. 5/6 (555 - 556) Maj - Qershor 2022

Revistë Fetaro-Kulturore

Drejtues

Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia:

Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)

Dom Vlash Palaj

Dom Gjovalin Simoni

Xhon Nika (Redaktor Teknik)

Adresa:

Arqipeshkvia Shkodër

Sheshi Gjon Pali II

Tel. 0222-42764 / Fax. 0222-43673

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

www.kishakatolikeshkoder.com

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT



PAPA: ZOTI VEPRON NË JETËN TONË TË PËRDITSHME

Papa: “Zoti nuk vjen në ngjarje të jashtëzakonshme, por vepron në monotoninë e përfaqhtë të ditëve tona, në ritmin nganjëherë të lodhshëm të aktiviteteve, në gjërat e vogla që ne i kryejmë me qëndresë dhe përvujtëri duke u përpjekur të bëjmë vullnetin e Tij”.

R.SH. - Vatikan

“Zoti nuk vjen në ngjarje të jashtëzakonshme, por vepron në monotoninë e përfaqhtë të ditëve tona, në ritmin nganjëherë të lodhshëm të aktiviteteve, në gjërat e vogla që ne i kryejmë me qëndresë dhe përvujtëri duke u përpjekur të bëjmë vullnetin e Tij”. Kështu pohon Papa Françesku në një tweet, sot 10 gusht, botuar në faqen @Pontifex.

Të kujtojmë gjërat e bukura të Zotit në jetën tonë

“I krishteri duhet t'i kujtojë mënyrat e rrethanat në të cilat e ndjeu praninë e Zotit në jetën e tij, sepse kjo e forcon në udhën e fesë”. Ky mendimi i Papës në homelinë e Meshës, kremtuar më 21 prill 2016, në kapelën e Shtëpisë së Shën Martës në Vatikan.

Duke folur për misterin e Zotit, që ecën me hapin tonë, Papa Françesku gjatë homelisë së Meshës, kremtuar më 28 qershor 2013 në kapelën e Shtëpisë së Shën Martës në Vatikan, tha se “Zoti na kërkon të jemi të durueshëm e të patëmetë, duke ecur gjithnjë në praninë e tij. Zoti e zgjedh gjithnjë rrugën për të hyrë në jetën tonë e kjo kërkon durim nga ana jonë, sepse jo gjithnjë bëhet i dukshëm. Prandaj, i krishteri të jetë durimtar e i paqortueshëm, duke ecur gjithnjë në praninë e Zotit.

Zoti nuk zgjedh gjithnjë të njëjtën mënyrë

Kur Zoti vjen në jetën tonë dhe të popullit të vet, nuk zgjedh gjithnjë të njëjtën mënyrë. Nuk ka protokoll veprimi i hirit të Zotit, nuk ekziston asnjë rregull. Një herë, tha Papa Bergoglio në homelinë e Meshës së 28 qershorit 2013, Zoti vepron në një mënyrë, më pas, në një mënyrë tjetër, por për të vepruar, vepron gjithnjë. Gjithnjë, ripohoi Papa, Zoti vjen të takohet me ne: “Zoti zgjedh gjithnjë mënyrën e vet për të hyrë në jetën tonë. Shpesh e bën këtë ngadalë, aq ngadalë, sa rrezikohemi ta humbasim durimin: Po Zoti ndërhyr në jetën tonë”.

Zoti na thotë vetëm atë, që ia pati thënë Abrahamit: 'Ec në praninë time e ji i përkryer', i paqortueshëm, e kjo është fjala e duhur. Ec në praninë time e përpiku të jesh i patëmetë. Kjo është

udha me Zotin e Ai ndërhyr, po duhet të presim, të presim çastin, duke ecur gjithnjë në praninë e tij e duke bërë çmos për të qenë të paqortueshëm. T'ia lypim këtë hir Zotit: hiri e ecjes gjithnjë në praninë e Tij, duke u përpjekur të jemi të paqortueshëm”.

Për çdo të krishterë, Jezusi ka një premtim e një mision

Kur vjen Zoti “kam frikë se kalon e nuk e kuptoj”: me këtë citim nga Shën Augustini, Papa Françesku gjatë homelisë së meshës kremtuar më 5 shtator 2013 në Shtëpinë e Shën Martës, në Vatikan, reflektoi për mënyrat me të cilat duket Jezu Krishti në jetën e të krishterit. Një premtim që ngushëllon, një kërkesë për bujari, një mision për t'u plotësuar: këto janë, sipas Atit të Shenjtë Bergoglio, mënyrat me të cilat Jezu Krishti prek dhe ndikon në jetën tonë.

“Gjithmonë, kur Zoti vjen në jetën tonë, kur kalon në zemrën tonë, na thotë një fjalë e një premtim: 'Ec përpara... me guxim, mos ki frikë, sepse ti do të bësh këtë, apo atë!' Është ftesë për mision, për ta ndjekur. E kur e dëgjojmë këtë ftesë, shohim se ka diçka në jetën tonë që s'shkon, që duhet ta ndreqim, dhe e lëmë kështu mënjane, me bujari. Ose, edhe kur ka ndonjë të mirë në jetën tonë, Zoti mund të na frymëzojë ta lëmë, për ta ndjekur më nga afër”.





DON NOSH GJOLAJ

KULTIVIMI I DURIMIT DHE I NJOHJES

(Pjesa e fundit)

Njeriu duhet me qenë gjithherë i natyrshëm dhe burimor edhe krijues



Tregohet një eksperiment të një profesorit me studentët. Profesori në orën e mësimit e merr një gotë dhe e mbushi me ujë. E ngriti përpjetë ashtu sa që të mund ta shohin të gjithë studentët. Dhe profesori i pyet studentët: “Çka mendoni sa e rëndë është kjo gotë?”

Disa studentët përgjigjet se ka 50 gram, tjerët 100 gram, disa të tjerët 125 gram.

Profesori përgjigjet: “Vërtetë, as unë nuk e di se sa peshon, derisa nuk e vëmë në peshore, për të ditur saksish peshën. Por unë desha diçka tjetër t’iu pyes. Çka do të ndodhin me mua një qoftë se unë e mbajë këtë gotë me dorën e ngritur për disa minuta.”

“Asgjë!” Përgjigjen studentët!

“Shumë mirë. Në qoftë se unë e mbajë gjithnjë këtë gotë me duart të ngritur për një orë?” Vazhdon profesori duke pyetur.

Një student iu përgjigjej shumë shpejt: “Do të fillojnë të dhembin dora!”

Thotë profesori: “Saktësisht, ashtu është. Por çka do të ndodhin në qoftë se unë e mbajë këtë gotë tërë ditën në dorën e ngritur?”

Përgjigjet një prej studentëve: “Dora do fillojnë të dhembin shumë nga pesha e gotës, ka mundësi që të ngurohen muskujt, dhe ka mundësi bile dora të paralizohet, dhe ashtu me siguri do të përfundoni te

mjeku.”

“Shumë mirë - vazhdon profesori – Deri sa ndodhin këto gjëra, çka mendoni mos vallë është ndërruar pesha e gotës?”

“Jo!” Një zëri i përgjigjen studentët

Vazhdoi profesori: “Atëherë çka është në pyetje shkaku i dhimbjes, ngurtësimit si dhe paralizës së muskujve?”

Studentët u gjeten të befasuam si edhe të hutuam për një situatë të tillë, dhe filluan të mendojnë ta zgjidhin enigmën.

Profesori vazhdon: “Çka duhet të bëjë në këtë rast, për ta çliruar dhe lehtësuar dhimbjen nga pesha e gotës?”

Dëgjohet një zë nga amfiteatri: “ulen! gotën në tokë!”

“Po po, kjo është përgjigja e sakët, që të ulet gota në tokë, dhe të lirohet dora” Thotë profesori. Dhe vazhdoi: “Kjo është e njëjta gjë që ndodh me problemet e juaja të jetës së përditshme, si edhe mendimeve të rënda. Mendoni për këto për disa minuta, është diçka normal, nuk ka asgjë të keqe. Por një qoftë i mbajmë me vete në mendjen time për një kohë më të gjatë, do të ndjeni dhimbje. Në qoftë se i mbani me muaj apo vite do ta ndjeni paralize që do të thotë se nuk jini në gjendje të punoni diçka tjetër.



Shumë është e rëndësishme për të menduar për situatë te tilla, apo përjetimet nga jeta e juaj, që nga këto i zgjidhim përfundimet, por edhe më e rëndësishme është që ta çlirojmë mendjen nga problemet e përditshme për çdo mbrëmje para se të shkojmë për të pushuar. Pa marrë parasysh për cilin problem është fjala, e mos harroni në fund të ditës uleni gotën në tokë!”

Njeriu i natyrshëm dhe burimor është papërsëritur dhe i gatshëm ta pranoj tjetrin ashtu siç është. Njeriu i natyrshëm, nuk mundohet vetëm ai me qenë ideal, por lufton të jetë ata çka është. Nuk humb energji, për ta ngritur vetveten mbi tjetrin, as nuk lejon që tjetri të nënçmoi apo të shkelet. Individ i natyrshëm orvatet për ta njohur veten mirë, dhe nuk lejon vetes për ta krijuar për vete pamjen ideale, për t'i pëlqyer vetes, por për t'i pëlqyer tjetrit. Ai është i vetëdijshëm se dashuria është diçka tjetër, për të cilën duhet orvatesh pandërprerë, gjatë tërë jetës. Po ashtu ai dallon, të jesh i paarsyeshëm dhe të jesh i mençëm për t'u treguar i arsyeshëm. Nuk ndje nevojën të fshehët pas ndonjë maskës, mundohet ta zgjedhin pamjet jo reale, që i ka mbi vete, qofshin ato mbivlerësimet apo nënvlerësimet.

Aftësitë momentale dhe stabilitetin e jetës e kanë pothuaj të gjithë njerëzit, edhe pse në momentet janë shumë të shkurtër. Personi i pjekur është i aftë momentet e bukura për t'i zgjatur. Ai eventualisht mund ta humbin tokën nën këmbë, mund të gaboje, mund të rrëzohet edhe kulla e besnikërisë, por nuk e humb përparësinë e natyrshme dhe nuk i frikohet mendimit burimor, po ashtu qëndron në ato pikëpamjet e veta pozitive dhe kreative. Tregohet i aftë për të dalluar faktet nga supozimet, edhe nuk imagjinon dhe nuk mendon se ai i ka në dorë të gjitha përgjigjet në pyetjet e jetës. E dëgjon tjetrin, i pranon qëndrimin e tjetrit, dhe i përforcon me pohimet e veta. Tjetrin e mrekullon dhe e respekton, nuk i pengon dhe nuk e dhunon. Individ i natyrshëm nuk fshehët pas paaftësive, por është përgjegjës për jetën e vet, dhe nuk lejon që ndonjë autoritet i dobët ta shkelin dhe ta shfrytëzojë për qëllimet e dobëta. Ai është i aftë me qenë i pavarur.

Individ i natyrshëm e di ta shfrytëzojë kohën në mënyrë racionale dhe drejtë, po ashtu është i gatshëm për t'u përgjigjen kërkesave të mjedisit (rrethit) dhe respekton vlerat e tjetrit. Ai është i vetëdijshëm se filozofia e kohës i ka ato dimensionet e veta, siç janë: koha e dhunës dhe koha e tolerancës; koha të jesh me tjetrin dhe koha e vetmisë, koha e luftës dhe koha e dashurisë, koha e punës dhe koha e lojës, koha e lotëve dhe koha e buzëqeshjes, koha e takimit dhe koha meditimit, koha e dialogut dhe koha e heshtjes, koha e vrapimit dhe koha e pritjes.

Për njeriun e natyrshëm, koha është arë, dhe nuk e

humb kohën që disponon me të por e shpie në veprim për të krijuar dhe për të begatuar jo vetëm jetën personale por edhe bashkësisë, qoftë martesore qoftë bashkësisë më të gjerë. Të jetosh në kohën e sotëm, nuk do të thonë ta mohosh të kaluarën, sepse pikëpamjet e tilla do të ishin vetëm marri dhe çmenduari, të cila do ta errësonte përgatitjen e ardhmes. Do të thotë, fituesit e njohin të kaluarën, jetojnë përgjegjësi e kohës së tashme dhe presin ardhmen me shpresë optimiste. Siç thotë fjala e urtë: nga e kaluara mësohemi, jetojmë tashmen, për ta krijuar të ardhmen.

Personi i natyrshëm mundohet gjithherë ta njohin kufijtë e vetes, ndjenjave dhe nuk ik prej kundërthënieve të brendshme. Nuk i lejon vetes, që të bëhet skllav i kundërthënieve të brendshme as nuk humb baraspeshën e jetës, ai e di mirë se kur është nën ndikimin e hidhërimit nuk vendos, po ashtu dallon edhe kur e hidhërojnë tjerët, edhe kur ky i hidhëron të tjetrin! Është i aftë ta mbajnë në duart e veta timonin e jetës dhe di mos ti kalojnë dritat e kuqe. Mandej i pranon botën emocionale, e cila i përngjan ujit të trazuar, pasi qetësohet dhe të kthjellohet uji atëherë do ta shprehin mendimin që mendon ti thënë atij tjetri apo shokut martesor, fëmijës etj. Edhe këtë e bënë me delikates dhe dashuri.

Personi i natyrshëm është spontan, nuk imponohet dhe është i kujdesshëm. Ka prirje për jetën e përditshme, siç është puna, loja, ushqimi, njerëzit, jeta seksuale etj. të gjitha këto i kryen në mënyrë spontane. Pa ndonjë fajësim, kënaqet mbi suksesin e arritur dhe pa ndonjë zili e pranon suksesin e tjetrit. Lirishtë arkëtohet, po ashtu tërhiqet nga arkëtimi. Njeriu i tillë e pranon disiplinën, për me pasur edhe ardhmen të mirë. Nuk frikohet të jetë ata çka është, edhe këtë e bënë në mënyrë të natyrshme, sigurinë nuk e kërkon në llogari e tjetrit as nuk lejon sigurinë e vet të manipulohet nga tjetri. (M. James - D. Jongeward, I lindur për fitore).

Po e përfundoj me një shembull të imagjinuar, ku qershia e shpëtoi kurorën e martesës:

Tregohet për një çift i ri, të cilët jo vetëm se e duan njëri tjetrin, por në të kundërtën ata garojnë mes vetes se kush i pari i shpreh tjetri botën emocionale të dashurisë. Po ashtu edhe ara disa muajve, para martese, ata bëfshin gara se cili do t'ia shpreh fjalët :”të dua, shpirti imë dhe zemra ime!” Po ashtu ishin edhe në gara se cili prej tyre do t'i thonjë tjetrit më shumë herë në ditë “të dua!”. Ose i cili do të jetë më origjinal dhe interesant për t'ia shprehur ndjenjat e dashurisë. Ashtu jeta në dashuri nuk ishte fare monotone, por freskuese dhe krijuese. Dukej se ata të dy e duan shumë njërin tjetrin, si të janë të lindur njëri për tjetrin, duke ia shprehur kënaqësinë si dhe ndjenjat e dashurisë njëri tjetrit.



Në një moment papritur diçka ndodhi, ashtu martesë ndërroj krejtësisht fizionominë e vetë. Kohët e fundit jeta e përditshme martesore ishte aq e tendosur, një xixë më e vogël e ndezte shamate, fyerjet, poshtërimin njëri tjetrit ashtu mjafton vetëm një fjalë për një grindje dhe luftë pa kompromis kundra njëri tjetrit.

Një natë prej netëve të lodhur dhe të rraskapitur nga situata e krijuar, vendosen si njëri ashtu edhe tjetri për të biseduar mbi gjitha gjërat që i ngarkojnë, për ta gjetur ndonjë zgjedhje që do të ishte e nevojshme për dy palët.

As njëri prej tyre nuk dëshironte divorcin por në njëjtën kohë ishin të vetëdijshëm se kështu nuk mund të ecet përpara, sepse nuk mund të jetohet në kanibalizmin martesor. Ishte shumë e qartë se nuk e kanë gjetur atë fjalën e duhur. Ashtu qëndronin njëri kundrejt tjetrit në heshtje të gjatë lidhur me kontradiktën shkatërruese të jetës së përbashkët për ta gjetur atë mënyrë për të dalë nga kjo rrugë qorre.

Papritmas bashkëshorti çohet në këmbë dhe e shkëputë heshtjen: "Më ra ndërmend diçka! Të shkojmë dhe ta mbledhim një latë për shembull një qershi në kopshtin tonë, dhe ta quajmë 'qershia e jon'! Në qoftë se për tre muajt e ardhshëm do të thahet

atëherë do të shkurorëzohemi (divorci). Një qoftë se qershia kapet dhe rritet si edhe zhvillohet, atëherë, ne duk do ti lejojmë vetes të mendojmë në divorc. Për këtë kohë mundemi të flemë ndaras, çdo njëri në dhomën e vetë. Çka mendon? A je për këtë ide?" pyet bashkëshorti bashkëshorten me një shikim të pasigurt, duke pritur përgjigjen..


Në momentin e parë ishte diçka e çuditshëm për gruan e tij, si një lloj çmendurie e – një qershi për ta përcaktuar fatin e një martesë, çfarë besëtytnie - Pas pak ajo mendoi si edhe e kuptoi se më mirë është ky propozimin, për situatën e pakrye dhe kaotike si edhe në fund edhe ajo u pajtua.

Të nesërmen së bashku shkuan në shitoren dhe e blenë një latë e quajtur qershia dhe e sjellin në shtëpi. Së bashku kërkojnë vendin më të përshtatëm në kopsht për ta mbjell, duke i ndihmuar njëri tjetrit në mbjellën qershisë.

Kaluan një muaj ditë, pas këtyre ngjarjeve.

Një prej netëve takohen në befasi burri dhe grua ja te dyert e errtë, gati ishte një aksident. Në fytyrat e tyre fillimisht ishte një habi, për tu kthyer në një ngjarje gëzimi. Te dy bartin me vete kovën me ujë, që e ujitshin për çdo natë qershinë e mbjell në kopsht.

Qershia, cila e shpëtoi kurorën e martesës!





Moter MARJETA GJOKA

Punëtore e Vogel e Zemrave të Shenjta

NJERIU SI PERSON DHE SI QENIE SHOQËRORE

«Në fakt, njeriu për nga natyra e vet e brendshme është një qenie shoqërore dhe nuk mund të jetojë e as t'i shprehë dhuntitë e veta pa mardhënie me të tjerët»

(Gaudium et Spes 12).



Kultura antropologjike nuk ka të bëjë ekskluzivisht me trupin dhe shpirtin, por ka të bëjë mbi të gjitha me njeriun si person, domethënë si një shpirt i mishëruar, unik dhe i papërsëritshëm i llojit njerëzor. Njeriu, si qenie kulturore, nuk është i parafabrikuar; Në fakt ai duhet të "ndërtohet" me duart e veta. Por sipas cilit projekt? Cilin model, nëse ka një, duhet të mbajë para syve? Platoni, Stoikët, Filoni, Plotini thonin që modeli i njeriut, është Njeriu ideal. Etërit e Kishës propozuan si model *l'Imago Dei*, domethënë *Logos*, Birin e Hyjit, pedagogu i madh. Siç shihet, këtu del në pah rëndësia e antropologjisë filozofike, nëse do të synojmë të mbështetemi ekskluzivisht në burimet e arsyes së pastër, për të përcaktuar projektin mbi të cilin do të vendoset kultivimi i njeriut. Në të vërtetë, i takon antropologjisë filozofike dhe jo shkencave të veçanta t'u përgjigjet pyetjeve të mëdha që kanë të bëjnë me natyrën e qenies njerëzore, me origjinën e tij të parë dhe me qëllimin e tij përfundimtar. Tani, e vërteta parësore dhe kryesore që Antropologjia Filozofike duhet të marrë parasysh është se njeriu është një qenie personale, që do të thotë se është një

qenie që i përket rendit të shpirtit. Person do të thotë pikërisht këtë, përkatësinë e tij në rendin e qenieve shpirtërore dhe jo më në atë të qenieve materiale. Për këtë arsye Shën Toma mund të thotë se: «*Persona significat id quod est perfectissimum in tota natura scilicet substantia in natura rationali*» (person do të thotë ajo që është më e përsosura në univers, domethënë një substancë me natyrë racionale), (Shën Toma i Akuit, *Summa Theologiae*, I, q. 28, a. 3). Njeriu i përket me qenien e tij, botës së shpirtit nëpërmjet intelektit dhe vullnetit, me të parën e njeh të vërtetën, me të dytën vazhdon të mirën. Është për këtë arsye kultivimi i njeriut si person dhe mbi të gjitha kultivimi i intelektit dhe i vullnetit. Gjon Pali II ka thënë: Kultura është ajo me të cilën njeriu si njeri bëhet më njeri, dhe i qaset më shumë qenies. Është gjithashtu këtu që themelohet dallimi midis asaj që bën, midis qenies dhe të pasurit. Gjithçka që ka njeriu nuk është e rëndësishme për kulturën, nuk është një faktor krijues i kulturës por, bëhet faktor i rëndësishëm për kulturën vetëm kur njeriu ndërmjetëson me pasurinë e tij, në këtë rast mund të jetë në të njëjtën kohë më i plotësuar si njeri në të



gjitha dimensionet e ekzistencës së tij, në gjithçka që karakterizon njerëzimin e tij, (krh. PAPA GJON PALI II, *fjalimi në UNESCO*, (Organizata e shteteve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën Sociale dhe Natyrore dhe për Kulturën), 02.06.1980).

Objektivi i kulturës ka qenë gjithmonë për ta bërë njeriun e kulturuar dhe të studiuar, që do të thotë ta bësh atë me të vërtetë një njeri, një person plotësisht i zhvilluar, gjë që ka çuar në realizimin e përsosur dhe të plotë të të gjitha mundësive dhe aftësive të njeriut, veçanërisht atyre më fisnike dhe më të larta: si intelekti dhe vullneti.

Jeta është një kultivim i vazhdueshëm dhe kjo duhet të bëhet me fisnikëri, (krh. H. I. MARROU, *Historia e edukimit të lashtë*). Ideali i kulturës, cilido qoftë ai në përmbajtjen e tij specifike, ka të bëjë gjithmonë me edukimin dhe përsosjen e plotë të personalitetit individual. E gjithë kjo në mënyrë që njeriut të mos i mbeten të jashtme vlerat që për të, herë pas here konsiderohen tipike njerëzore, (krh. F. Barone, *epoka teknologjike*). Njeriu si person, është në vetvete dhe në të njëjtën kohë e kapërcen vetveten. Intelekti dhe vullneti karakterizojnë dhe përcaktojnë qenien e tij, dhe pikërisht për këto aftësi njeriu është i destinuar të kapërcejë vetveten, sepse falë intelektit ai e kapë qenien në të gjitha dimensionet e tij dhe falë vullnetit ai drejtohet në një farë mënyre për ta përvetësuar atë. Prandaj qenia personale e njeriut nuk është një qenie e mbyllur në vetvete, por ai është një qenie e hapur dhe komunikuese me të tjerët, mbi të gjitha me të ngjashmit e tij, në këtë pikë pa ndihmën dhe bashkëpunimin, jo vetëm edukimi është i pamundur, por edhe vetë ekzistenca e tij. Qenia personale e njeriut është në fakt në thelb një qenie shoqërore. Prandaj është më se e drejtë që t'i kushtohet vëmendje e duhur aspektit shoqërorë dhe edukimit.

Ne vërejmë para së gjithash me Maritain se problemi qendror i edukimit shoqëror, konsiston në zëvendësimin e individualizmit të epokës borgjeze. Jo me totalitarizëm apo me kolektivizëm, por me një qytetërim personalist dhe komunitar, të bazuar në të drejtat e njeriut dhe që plotëson aspiratat dhe nevojat shoqërore të njeriut. Edukimi duhet t'i japë fund mospërputhjes midis nevojave sociale dhe individuale të vetë njeriut, (krh. J. Maritain, *Edukimi në udhëkryq*). Dy ekstremizmit e kundërta kundrejt të cilëve qëndron personalizmi i komunitetit, ata janë individualizmi liberal dhe egalitarizmi i parimeve ideologjike, i pari është viktimë e ekuivocitetit të qenies dhe pretendon se çdo individ është absolutisht i ndryshëm nga të gjithë individët e tjerë me të cilët ai nuk ka asgjë të përbashkët, ndërsa e dyta viktimë e univocitetit të qenies, për të cilën

çdo njeri nuk do të ishte gjë tjetër veçse një mënyrë e të qenit i një njerëzimi të vetëm. E vetmja rrugëdalje është koncepti i analogjisë që pohon një barazi proporcionaliteti. Kështu e shpjegon Maritain zbatimin e konceptit të analogjisë në rastin konkret. Njerëzimi është i plotë në çdo njeri, por nuk është i plotë në çdo individ. Asnjë njeri nuk është njeri në thelb, domethënë në vetvete e gjithë pasuria e përsosmërive për të cilat është i aftë lloji njerëzor, në këtë kuptim i gjithë diversiteti i përsosmërive dhe virtyeteve që brezat njerëzor ndajnë në hapësirë dhe kohë nuk është veçse një i ndryshëm. Pjesëmarrja në virtualitetet, të përbashkëta dhe të pashtershme të njeriut.

Njeriu për natyrë është një qenie shoqërore

Njeriu nuk është i shoqërueshëm vetëm për nevojshmërit e tij, si për veshjen, shtëpinë, shkollën, siç tregon përkufizimi i Aristotelit, por ai është i shoqërueshëm mbi të gjitha falë zemërgjerësisë së tij që e ndihmon që të dhurohet, të angazhohet në shoqërinë ku ai jeton. Njeriu nuk është vetëm bashkëjetues, por edhe proekzistent, ai jeton me të tjerët por edhe më shumë duhet të jetojë për të tjerët. Njeriu është egoist, por ai është gjithashtu një egoitet (domethënë një Unë i qëndrueshëm) i hapur ndaj tjetrit dhe i destinuar të zhvillohet pikërisht në masën që i jepet tjetrit. Kemi këmbëngulur vazhdimisht se njeriu është një projekt i hapur dhe duhet të kultivohet, tani është e qartë se kultivimi duhet bërë jo aq me marrjen, por me dhurimin. Në fakt, nga akti krijues i Zotit, në të cilin ai thellon bujarisht thesaret e urtisë së Tij për dashurinë ndaj krijesës, e cila nuk ka të drejtë të jetë, deri te lindja njerëzore, fizike dhe shpirtërore, nuk është e drejta, por është dashuria falas, dhurimi, që shtyn shumëfishimin e qenieve dhe të mirave. Socialiteti shprehet më plotësisht në nivelin e vlerave të shpirtit. Në fakt, ndërsa të mirat materiale që do të zotërohen nga shumë duhet të ndahen dhe për këtë arsye secila të zvogëlohet, të mirat shpirtërore të ndara shumohen dhe rriten për të mirën e të gjithëve. Kështu njeriu është në mënyrë intime shoqëror nga vetë struktura e qenies së tij, ai lind i shoqërueshëm dhe bëhet shoqëror nëpërmjet edukimit, (krh. P. Viotto, *për një filozofi të edukimit sipas J. Maritain*). Personi njerëzor është qendra e marrëdhënies shoqërore, sepse është themeluar në Hyjin, rrjedh nga Hyji dhe kthehet te Hyji. Nuk ka vëllazëri pa bijësi nga i njëjti Atë, dhe ne jemi vëllazër për faktin sepse jemi bijë të të njëjtit Atë. Në këtë pikë, çështja e marrëdhënies midis individit dhe shtetit duhet të sqarohet, duke pasur parasysh dallimin midis individit dhe personit. Personi, siç e pamë, është një



banues në botën e shpirtit, është krijuar nga Hyji dhe ka përfundimin e tij tek Ai. Në vend të kësaj, individi thjesht thotë ndarjen e brendshme të një gjëje dhe dallimin e saj nga çdo gjë tjetër. Tani njeriu si individ i nënshtrohet tërësisht shoqërisë, dhe kjo në rast nevojë për të kërkuar sakrificën e jetës së tij, përkundrazi, si person, ai është mbi të gjitha të drejtat e shoqërisë dhe të shtetit. Si person ai i përket "qytetit qiellor" dhe për këtë arsye i shpëton totalitarizmit të qytetit tokësor. Prandaj edukimi Shoqëror është një aspekt i rëndësishëm, por nuk është i gjithë edukimi, edukimi social nuk është qëllimi parësor i edukimit, por i dyti nga qëllimet thelbësore të tij. Qëllimi parësor i edukimit ka të bëjë me njeriun në jetën e tij personale dhe në përparimin e tij shpirtëror, jo në marrëdhëniet e tij me mjedisin

Moral dhe shoqëri, parimet e etikës sociale). Çdo popull jep një kontribut origjinal për të mirën e përbashkët të njerëzimit. Prandaj, edukimi për mirëkuptim dhe bashkëpunim midis njerëzve dhe brenda çdo shoqërie, duhet të plotësohet me edukimin për mirëkuptim dhe bashkëpunim midis popujve të ndryshëm brenda njerëzimit të përbashkët. E mira e përbashkët realizohet nga angazhimi i gjithësecilit prej nesh. Duhet të qartësohemi edhe me atë çfarë nënvizon *Gaudium et Spes* që, «veprimtaria njerëzore siç buron prej njeriut është edhe për njeriun. Në të vërtetë, njeriu kur punon, nuk i shndërron vetëm gjërat dhe shoqërinë, por edhe përsos vetvetën. Mëson shumë gjëra, zhvillon aftësitë e veta, del prej vetvetes dhe tejkalon vetveten. Ky zhvillim, nëse kuptohet, vlen



shoqëror, (krh. J. Maritain, *Edukimi në udhëkryq*).

Edukimi për të ekzistuar me njerëzit është një nga detyrat themelore të edukimit shoqëror, e cila duhet t'i japë çdo qytetari vetëdijen për t'u ndjerë si pjesëtar i një komuniteti, i cili ka një histori dhe është misioni i tij brenda njerëzimit. Kjo e drejtë e gjen themelin e saj metafizik në ekzistencën e Hyjit, me anë të së cilës ligji i përjetshëm kapërcen dhe bashkon ligjin pozitiv të shteteve individuale, jo vetëm në vlerën e tij morale, por edhe në vlerën e tij legjitimore, duke respektuar vlerën themelore të njeriut. Duhet të qartësohemi se, çdo popull përbëhet nga një lloj personi moral i pajisur me unitetin e vet të brendshëm të pjekur dhe të shprehur në traditën e komunitetit, (krh. V. B. Benetollo,

më shumë se pasuritë e jashtme që mund të grumbullohen. Njeriu vlen më shumë për atë që është se për atë që ka. Po ashtu, gjithçka që njerëzit bëjnë me qëllim që të arrijnë një drejtësi më të madhe, një vëllazëri më të gjerë dhe një rend më njerëzor në marrëdhëniet shoqërore, ka më shumë vlerë se sa përparimet në fushën teknike», (*Gaudium et Spes*, n. 35).

Në sferën shoqërore roli pedagogjik që i takon familjes është themelor. Njeriu për nga natyra është i shoqërueshëm dhe shoqëria e parë të cilës i përket është familja. Nga dashuria e prindërve ai merr ekzistencën e tij, dhe nga dashuria e tyre ai merr edukimin e parë. Në gjenerimin dhe edukimin e fëmijëve, krijimtaria njerëzore arrin kulmin. Janë



projekte të reja të njerëzimit që fitojnë të qënurit me punën e prindërve dhe gjejnë vend në shoqëri. Fëmijët me praninë dhe nevojat e tyre, varësinë dhe brishtësinë e tyre, procesin e tyre edukues, përcaktimi i projektit të tyre njerëzor dhe realizimi i tyre fillestar i japin një kuptim më të plotë jetës së prindërve. Familja është bashkësia në të cilën që nga fëmijëria, njeriu mund të marrë vlera morale, mund të fillojë të nderojë Hyjin dhe të shfrytëzojë mirë lirinë.

Jeta familjare është një fillim i jetës në shoqëri, (krh. *Katekizmi i Kishës Katolike*, n. 2207). Por edhe familja luan një rol themelor në lidhje me kulturën, e kuptuar si forma shpirtërore e një shoqërie, formë që bashkon anëtarët e saj dhe i dallon ata nga anëtarët e çdo shoqërie tjetër, nëpërmjet një gjuhe, nëpërmjet kostumëve dhe teknologjive, vlerave dhe institucioneve të caktuara. Në këtë kuptim familja është bërthama e parë konstituive e kulturës, familja për të siguruar nevojat e veta dhe dominimin e mjedisit natyror vendos themelet e para të kulturës. Konfirmimin e kësaj të vërtete në botën tonë të sotme mund ta gjejmë edhe në familjet më të mëdha patriarkale, veçanërisht në fshatra. Ata ende ruajnë mini-kulturën e tyre, e përbërë nga disa shprehje gjuhësore të njohura vetëm nga anëtarët e familjes, me zakone dhe vlera të kufizuara në rrethin e saj familjar. Prandaj familja është një matricë e kulturës

dhe jo thjesht një zinxhir transmetimi i një kulture të imponuar nga shoqëria. Mund të pohojmë se vlera pedagogjike e familjes është aq e madhe dhe e pazëvendësueshme sa nuk mund dhe nuk duhet të errësohet kurrë, aq më pak në një shoqëri të shpërbërë, kaotike, çnjerëzore dhe barbare si kjo e jona.

Familja është e vetmja rrugë shpëtimi për shoqërinë tonë. Në të vërtetë, vetëm në familje mund të rikuperojmë ato vlera të përhershme dhe absolute, ato shpirtërore, të cilat shoqëria jonë i ka humbur dhe i ka mohuar. Duke qenë se shoqëria industriale kërcënohet nga fenomeni masiv dhe nga masivizimi, nga mekanizimi dhe humbja e shpirtit dhe nga izolimi, burokratizimi dhe pafuqia e shtetit, familja në formën e saj të re është ajo moderne si mbrojtje e shpirtit, personalitetit, veçantia e papërsëritshme, liria, morali, përgjegjësia e drejtpërdrejtë për të tjerët, e jo më pak për fenë, ka një mision specifik dhe të pazëvendësueshëm, (krh. J. David, "Familja", në *Sacramentum mundi*, Enciklopedi Teologjike III). Prandaj kjo është norma e veprimtarisë njerëzore, që sipas planit të Hyjit dhe vullnetit të tij t'i përgjigjet të mirës së vërtetë të njeriut, dhe që ti lejojë njeriut, të konsideruar si individ apo si anëtar i shoqërisë, të kultivojë e të zbatojë thirrjen e vet të tërësishme, (*Gaudium et Spes*, n. 35).





DITËT QËNDRESËS, 20 – 24 MAJ 2022

20 Maj – Dita e Parë

Hapja zyrtare e ditëve të Qëndresës dhe kremtimi i 4 vjetorit të inaugurimit të Monumentit kushtuar persekutimit dhe qëndresës së popullit të Shkodrës, gjatë regjimit komunist.

Aktiviteti u hap me ekzekutimi himnit kombëtar. Më pas Moderatorja Rajmonda Marku theksoi faktin se tre vite më parë, në këtë shesh me rastin e hapjes zyrtare të "Ditëve të Qëndresës", Shkodra shleu një amanet, kreu një detyrë, plotësoi një premtim. Shkodra, simboli i persekutimit komunist, vendosi ti nderonte, vuajtjet, sakrificat po edhe qëndresën e bijve dhe bijave të sajë, duke ngritur këtë monument madhështor. - U desh, theksoi ajo, - këmbëngulja e vazhdueshme e ish të persekutuarve dhe të përndjekurve politike të Shkodrës me drejtues z. Zenel Drangu, që me në fund Bashkia Shkodër, me kryetar z. Lorenc Luka, të miratonte vendi ku do të ndërtohej ky monument si dhe të kryetares së mëvonshme të Bashkisë Shkodër, zj. Voltana Ademi që projekti të marre jetë. Por sigurisht, një meritë të veçantë për bërjen realitet të këtij projekti, ka Komisioni Drejtësi dhe Paqe, strukturë kjo e Kishës Katolike në Shqipëri i cili jo vetëm e inicioi dhe e ndoqi procesin që nga konkursi dhe përzgjedhja e kësaj veprë dinjitoze deri në realizimin e saj, por edhe siguroi pjesën më të madhe të buxhetit për ndërtimin e tij, nëpërmjet donatoreve tashme të njohur: Konferenca



Ipeshkvnore Amerikane dhe fondacionet gjermane Renovabis dhe Maximilian Kolbe.

Më pas në emër të Shoqatës së të persekutuarve dhe të burgosurve politikë, fjalën e mori zoti Zenel Drangu, kryetar i kësaj Shoqate, i cili falënderoi Bashkinë Shkodër, Komisionin Drejtësi dhe Paqe, donatoret dhe bashkëpunëtorët, si dhe autorin e monumentit, i cili sipas tij, shpreh me se mire vuajtjet dhe sakrificat e popullit të Shkodrës gjatë regjimit komunist.

Shkëlqesia Tij, Imzot Angelo Massafra, në fjalën e tij falënderoi të gjithë ata që morën pjesë dhe kontribuan në ngritjen e këtij monumenti. Ai theksoi rëndësinë e njohjes dhe ballafaqimin me të kaluarën komuniste, pa komplekse, pa shpëlarje truri. - Këto monumente, theksoi ai, - duhet të na shërbejnë si vend pelegrinazhi dhe meditimit, për të

kujtuar dhe respektuar vuajtjet e mëdha që populli ynë ka kaluar gjatë periudhës së diktaturës komuniste.

Kryetari Bashkise Shkoder Zoti Bardh Spahia në fjalën e tij, vlerësoi organizimin e Ditëve të Qëndresës sepse siç tha ai - synojnë të na sjellin në mend qëndruesen e pashoqe të shqiptareve ndaj diktaturës komuniste.- Ditët e Qëndresës – theksoi ai, - janë edhe një mundësi për të komunikuar intensivisht me të rinjtë e të rejtat, sidomos ata që kanë lindur pas viteve '90 pasi ata duhet të njihen me të vërtetat e persekutimit komunist.

Me pas zoti Luigj Mila në fjalën e tij, theksoi faktin e mungesës se





interesimit nga ana e strukturave shtetërore në drejtim të ruajtjes, mirëmbajtjes dhe përdorimit për informimin e publikut të objekteve të represionit. - Shumë shpejt – theksoi ai, - nuk do jemi më në gjendje të informojmë brezat e ardhshëm për krimet e komunizmit sepse nuk do kemi me prova konkrete.

21 Maj 2022 - Dita e Dytë

Në Ditën e dytë të Qëndresës aktiviteti u spostua disa kilometra larg nga Shkodra dhe konkretisht në ish burgun e Spaçit, ku u përkujtua 49 vjetori i Revoltës në këtë burg. Në mes të pjesëmarrësve, përveç ish të burgosurve politikë të këtij burgu ishin edhe të rinj e të reja të shkollës së mesme Rrëshen si dhe autoritete të lartë fetare, diplomatike dhe civile. Nder të tjerë mund të përmendim ipeshkvën e Rrëshenit, Sh. T. Imzot Gjergj Meta, ambasadorin e Austrisë në Shqipëri, Dr. Christian Steiner, drejtorin Fondacionit Konrad Adenauer Dr. Tobias Rüttershoff, drejtoreshën e IDMC (Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë) Zj. Jonila Godole, organizate e cila, po ashtu, çdo vit organizon një cikël të gjere aktiviteteve përkujtimore të quajtura “Ditët e Kujtesës”. Aktiviteti u hap me ekzekutimin e himnit kombëtar ndërsa një ish pjesëmarrës në Revoltën e Spaçit të 23 majit 1973, z. Xhavit Lohja ngriti flamurin, i njohur tashme si “flamuri me vrimë”

Me pas me radhë fjalën e morën autoritetet e pranishme duke theksuar faktin nevojës së ruajtjes së këtyre objekteve të rëndësishme për kujtesën tonë kolektive si dhe përkujtimin e ngjarjeve të veçanta si është Revolta e Spaçit, si një pike kulmore e qëndrues ndaj diktaturës komuniste.

Sh. T. Imzot Gjergj Meta, pasi drejtoi lutjen e posaçme ndërfetare, në fjalën e tij u ndal në rëndësinë e organizimit të këtyre aktiviteteve duke kujtuar faktin se 23 Maji i vitit të ardhshëm përkon me 50 vjetorin e kësaj Revolte, kërkoi angazhimin e të gjithëve që këtë ngjarje të rëndësishme të ballafaqimit tonë me të keqën ta përkujtojmë në mënyrën më të mirë të mundshme. Ai shprehi angazhimin e tij të plotë në vënien në dispozicion të koordinimit të aktiviteteve përkujtimore që pritet të organizohen në këtë përvjetor gjysmëshekullor.

Ambasadori i Austrisë në Shqipëri Dr. Christian



Steiner në fjalën e tij falënderoi organizatorët për ftesën dhe për përgatitjen e këtij aktiviteti të rëndësishëm. Ai e vlerësoi se tepërmi praninë e të rinjve e të rejave në një vend të veçantë siç është ish burgu i Spaçit.

Në fjalën e tij drejtori Fondacionit Konrad Adenauer Dr. Tobias Rüttershoff, duke nënvizuar nevojën e bashkëpunimit ndërmjet të gjitha institucioneve të ngarkuara për zbardhjen e krimeve të komunizmit, i informoi të pranishmit për kontributin që ka dhënë dhe po jep ky Fondacion në mbështetjen dhe inkurajimin e realizimit të aktiviteteve të ngjashme si dhe në financimin e studimeve dhe botimeve të shumë veprave të llojeve dhe karaktereve të ndryshme të cilat kanë ndihmuar në hedhjen dritë mbi të vërtetat e persekutimit komunist në Shqipëri.

Zj. Jonila Godole theksoi faktin e rëndësishëm që ka realizimi i këtyre aktiviteteve përkujtimore dhe informuese, sidomos për brezat e rinj. Gjithashtu ajo u angazhua për të dhënë kontributin e saj maksimal në kremtimin e 50 vjetorit të Revoltës së Spaçit. Z. Godole gjithashtu edhe një herë ka marrë temën e Ditës së Kujtesës, duke e përafëruar atë me 21 Majin, ditën e Revoltës së Spaçit. Ajo angazhua për të përdorur të gjitha mjetet që parashikon ligji për ta shpallur këtë ditë Dita e Kujtesës Kombëtare.

Z. Luigj Mila, i cili ishte organizatori dhe moderatori i këtij aktiviteti, theksoi faktin e mungesës së interesimit për vende të ngjashme si ish burgu i Spaçit. - Në kemi 4 martire, tha ai – 4 ish të burgosur të Spaçit të cilët patën guximin t'i kundërviheshin komunizmit, në kulmin e tij. Ata u ekzekutuan dhe u groposën nuk dihet se ku, duke shkelur kështu jo vetëm ligjet e kohës por edhe



traditat me të mira të popullit tonë i cili edhe armikut me të egër ia respekton vdekjen dhe lejon zbatimi e ritualit sipas traditës. Kjo gjë nuk ndodhi me katër të pushkatuarit e Spaçit; Hajro Pashaj, Pal Zefi, Dervish Bejko dhe Skender Daja. Shteti Shqiptar e ka për detyrë ti gjeje këta heronj dhe ti varros me respektin e merituar. Dhe kjo do ishte gjest njerëzor dhe një surprizë e bukur për familjarët dhe bashkëvuajtësit në 50 vjetorin e Revoltës së Spaçit.

22 Maj 2022 - Dita e Tretë

Ceremonitë dhe aktivitetet e organizuara me Ditën e Tretë të Qëndresës dallonin nga vitet tjera pasi për herë të parë u zgjodh vendi tek ish antenat e Radio-Shkodrës në fashtin Kuç, në një vend me ngarkesë të madhe simbolike, emocionale dhe historike. Këtu u groposën trupat e dy pjesëmarrësve në Revoltën e Qafe-Barit, Sokol Sokoli dhe Tom Ndoja të çilet u ekzekutuan gati 40 vjet me pare, si organizatore të Revoltës së Qafe-Barit të 22 Majit 1984. Trupat e tyre u gjeten nga familjarët vetëm në maj të vitit 2011.

Në këtë aktivitet merrnin pjesë rreth njëqind persona, familjare të martireve, miq e bashkëvuajtës si dhe drejtues të shoqatave të ish të përndjekurve politike nga e gjithë Shqipëria. Po ashtu merrte pjesë edhe Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëv Shkodër-Pult, Kryetar i Konferencës Ipeshkvnore Shqiptare si dhe President i Komisionit Drejtësi dhe Paqe. Ky aktivitet u modelua nga Xh. Raimonda Marku e cila beri një përmbledhje të shkurtër të ngjarjeve të ndodhura në

ketë vend, duke theksuar rëndësinë që ka për të gjithë në respektimi e vendeve të vuajtjeve dhe nderimi i viktimave.

Imzot Massafra në fjalën e tij e vuri theksin tek rëndësia që ka gjetja e trupave të ekzekutuar gjatë regjimit komunist të çilet janë varrosur në vende të panjohura. – Ne, theksoi ai – në Kishën Katolike në Shqipëri kemi 38 martirë dhe vetëm 10 prej tyre u kemi gjetur trupat. – Le të shërbejë kjo ditë dhe ky vend, theksoi ai, – si moment reflektimi dhe përgjegjësie për organet ligjvënëse dhe ligjzbatuese për tu ngritur në nivelin që ua kërkon detyra dhe përgjegjësia dhe për të vënë në vend drejtësinë dhe moralin njerëzor, duke bërë të mundur gjetjen e trupave të të zhdukurve gjatë regjimit komunist.

Edhe folësit e tjerë në fjalën e tyre, nënvizuan rëndësinë që ka gjetja dhe rivarrimi i të humburve gjatë diktaturës komuniste.

23 Maj 2022 - Dita e Katërt

Në këtë ditë radhën e kishte vizata në Burgun e Qafë-Barit. Aktiviteti në të cilin merrnin pjesë shumë ish të burgosur politik, drejtues shoqatash, si dhe shumë të rinj dhe të reja nga qytete të ndryshme të vendit. Aktivitete e kësaj dite u organizuan dhe u drejtuan nga Instituti i Integritetit të Përndjekurve Politike në bashkëpunim me Komisionin Drejtësi dhe Paqe, u mbajt në oborrin e ish burgut famëkeq. Organizatorët e takimit u dhënë fjalën me radhe drejtuesve të shoqatave dhe institucione të pranishëm në takim. Këta të fundit theksuan rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit me qellim rritjen e efektshmërisë dhe shmangien e debateve dhe konflikteve të cilat nuk kanë qenë të radha kohët e fundit.

Me pas të pranishmit vizituan ambjentet e ish burgut të cilat për hire të së vërtetës janë lënë në mëshirë të fatit dhe agjenteve atmosferikë, duke degraduar çdo ditë që kalon.

Me pas Instituti i Integritetit të Përndjekurve Politike ofroi një drekë për të pranishmit në këtë aktivitet. Dhe kështu u mbyll edhe dita e katërt e dhe krejt aktivitetet organizuar me rastin e Ditëve të Qëndrues 20-24 Maj 2022.

Përgatit: Luigi Mila





NGA HISTORIA E SAJ, E RRËFYER NGA KËTA GURË!

*Fjala për konferencën shkencore në Prizren të Imzot Angelo Massafra O.F.M.
Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult dhe President i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë.*

Prizren, 11 qershor 2022

Mirëdita të gjithëve!

Përshëndes të gjitha autoritetet civile dhe fetare!
Përshëndes dhe falënderoj Imzot Dodë Gjergjin për ftesën! Përshëndes Dom Shan Zefin, Vikar Gjeneral dhe famullitar! Meshtarët dhe Rregulltarët, Kryeartin e Qytetit dhe Arkeologet, Përshëndes të gjithë folësit! Përshëndes të gjithë ju të pranishmit!

Jam i nderuar të jem i pranishëm sot në këtë Konferencë shkencore edhe në emër të sivëllezërve të mi Ipeshkvij të Shqipërisë, përveçse si Arqipeshkëv i Shkodër-Pultit, një dioqezë e cila, së bashku me Prizrenin, mburret për një histori shekullore të saj.

Për këtë histori flasin gurët e kësaj katedrale, ndërtesë fizike që mbledh një ndërtesë tjetër, më shpirtërore, atë të Kishës së përbërë nga gurë të gjallë, dmth. nga besimtarët, sipas mësimi të Pjetrit apostull.

E dimë se këtij mësimi i bën jehonë edhe Pali apostull, në kalimin e të cilit nëpër Iliri mund të gjurmojmë përhapjen e krishterimit në trojet tona. Pali flet për Kishën si një trup, gjymtyrët e të cilit janë të bashkuara në mënyrë të përkryer deri në atë pikë sa secili t'i ndiejë gëzimet dhe vuajtjet e gjymtyrëve të tjera.

Prandaj sot gëzohem me këtë Kishë vendore në Kosovë, e cila nga historia e saj, e rrëfyer nga këta gurë, mund ta gjurmojë thirrjen e vet edhe më tej, për ta jetuar atë me një entuziazëm të përtërirë.

Dhe, në të njëjtën kohë, ju uroj që ta zgjasni në kohë këtë gëzim për dy arsye, gjithmonë të lidhura me mësimet apostolike: së pari sepse nga një dëshmi e gëzueshme e fesë lindin gjithmonë thirrje të reja; dhe pastaj edhe që efektet e dobishme të këtij gëzimi të përhapen në të gjitha Kishat e tjera.

Le të mësojmë nga e kaluara për ta jetuar mirë të tashmen dhe për të ndërtuar kështu të ardhmen; gjithmonë duke bërë të mirën dhe kurrë të keqen. Urimet më të mira për të gjithë ju. Duc in altum!





SHUGURIMI DIAKONAL I DOM FATION MULLARTHI

*“Biri i njeriut nuk erdhi për të qenë shërbyer,
por që të shërbejë e të japë jetën e vet si shpërblim për të gjithë.” (Mk 10,45)*

Me datë 20 maj, në përkujtimin liturgjik të Shën Bernardinit nga Siena, Dioqeza e Shkodrës pati gëzimin e shugurimit Diakonal të Dom Fation Mullarthit. Në meshën Shenjte që u kremtuar nën udhëheqjen e Arqipeshkvitë të Shkodër-Pult, Imzot Angelo Massafra, ishin të pranishëm edhe Arqipeshkvi i Tiranë- Durës, Imzot Arjan Dodaj, Vikarët e Dioqezave të tjera të Shqipërisë si dhe një numër i madh meshtarësh të Dioqezës së Shkodrës, të dioqezave të Shqipërisë por edhe nga Mali i Zi dhe Kosova.

Përgatitja për ditën e shugurimit ka qenë mjaft e gjatë, ashtu siç e do edhe vetë ecja e formimit meshtarak. Prandaj, me shumë dëshirë, mund dhe sakrificë por edhe me një gëzim të thellë që vjen nga misteri dhe bukuria e thirrjes, e kam lënë veten të formohem nga dora e mëshirshme dhe drejtuese e vetë Krishtit, i cili më thirri që t'i shërbej më afër në Elterin Eukaristik, duke u shërbyer njëherazi edhe më të varfërve.

Gjatë Meshës së Shenjte kam provuar emocione të veçanta, sidomos në momentin e Shugurimit. E kam ndier gjithmonë në vete forcën e lutjes së shumë personave që më kanë premtuar lutjet e tyre, po kështu edhe mbështetjen e kishës qiellore me ndërmjetësimin e shenjtërvë në këngën e Litanive të shenjta.

Diakonati, ka në përbërjen e tij të thellë *shërbimin*. E këtë virtyt, na e ka lënë porosi vetë Krishti: *Sikurse unë ju bëra juve, ashtu duhet të bëni edhe ju*, porosi kjo e darkës së fundit. Me anë të shugurimit, mora mbi vete këtë dhuratë: t'i shërbej Zotit e të tjerëve; por edhe ndiej përgjegjësinë që këtë virtyt ta bëj pjesë të jetës sime, ose stil të jetuarit meshtarak. E kjo nuk është mbi të gjitha sforcim i vullnetit tim, i tejkalon forcat e mia; pra, është dhuratë e hirit të tij, që ka nevojë dita ditës të ushqehet me lutje, me shembull jete dhe me lidhje të ngushtë me Atë që na ka thirrur në këtë shërbim.

Falënderoj Zotin, autorin dhe përkryesin e çdo thirrje, që më ka zgjedhur mua si bashkëpunëtor të Tijin. Mirënjohje, për Mons. Angelon, që më ka shoqëruar e mbështetur përgjatë ecjes formuese. Gjithashtu falënderoj të

gjithë ata persona (formatorë të ndryshëm e etër shpirtëror) që janë kujdesur për mua në mënyra të ndryshme gjatë këtyre 8 viteve, që të arrij tek kjo ditë e shugurimit Diakonal.

Jam i sigurt se ashtu siç kanë bërë shumë persona tash sa vite që në heshtje e më këmbëngulje duke u lutur për mua, do të vazhdojnë ta bëjnë edhe më shumë tani, sepse me shugurimin nuk mbyllet një proces por fillon një ecje më e afërt me Krishtin shërbëtor.

Zoja e Këshillit të Mirë, Shën Nënë Tereza e Martirët e Lum të Shqipërisë, mos më lëshofshin dore gjatë jetës sime! Amen

*Dom Fation Mullarthi
Diakon*





KEMI ENDE SHUMË PËR TË REFLEKTUAR MBI VLERËN E JETËS!

Dita e tokës, 22 prill 2022

Me 22 prilli: Dita e Tokës, e cila tashmë festohet që nga viti 1970, por që vetëm vitet e fundit po merr përmasa gjithnjë e më të mëdha, edhe falë krizës aktuale të pandemisë para dhe tani të luftës në Ukrainë, jehonë shurdhuese e luftërave të shumta që zhvillohen ende në vende të ndryshme të globit.

Kemi ende shumë për të reflektuar mbi vlerën e jetës dhe një ndërgjegjësim serioz, sesa e rëndësishme është të investosh në "cilësinë e jetës" dhe jo thjesht të përpiqesh "të mbijetosh", duket larg.

Po ashtu, duket se as thirrjet dhe fjalët që janë shpenzuar vitet e fundit për të kujtuar përgjegjësinë e përbashkët ndaj shtëpisë sonë të përbashkët nuk po japin efektin e dëshiruar, të paktën në sistemet e mëdha të cilat, duke u angazhuar për nënshkrimin e marrëveshjeve, caktojnë data të largëta për realizimin e ndryshimeve reale cilësore.

Por ndoshta ka një rrugëdalje që nuk kërkon ngadalësimin e hapit për të pritur vendimet e të mëdhenjve të tokës: është rruga "nga poshtë", ajo që secili prej nesh mund të ndërmarrë me lehtësi dhe me pak mundim, duke vënë në veprim të gjitha ato masa paraprake që, nëse miratohen, mund të sjellin vërtet ndryshim.

Të nxitur nga enciklika e Papa Françeskut

"Laudato si", edhe bashkësitë fetare janë aktive në këtë drejtim dhe ia kushtojnë muajin shtator sensibilizimit të përvitshëm për këtë çështje. Megjithatë, sot është e rëndësishme që ta pyesim veten: a mund të ketë një angazhim për një shtëpi të përbashkët nëse familja njerëzore copëtohet nga tmërri i luftës?

Prandaj, angazhimi për ruajtjen e mjedisit duhet të jetë në gjendje të shkojë paralelisht me një ndjeshmëri dhe përgjegjësi të shtuar për paqen, jo aq si mungesë lufte, por si një qëndrim i brendshëm personal që duhet t'i prekë të gjitha fushat e jetës njerëzore.

Paqja që Krishti u jep ndjekësve të vet natën e Pashkës gjithë hapësira reale konkretizimi në jetën e secilit prej nesh dhe i Ngjalluri i bekoftë përpjekjet e të gjithëve, besimtarë dhe jobesimtarë, për realizimin e një "ekologjie integrale" që e shpëton njeriun nga vetja e vet.

† Angelo Massafra O.F.M.

*Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult
President i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë
Ipeshkev Përgjegjes për ruajtjen e Krijimit CCEE
Anëtar i Komisionit Baritor Shoqëror CCEE*





SHËMBËLLESË E LARGËT E TEMPULLIT TË AMSHUAR

*Kisha e re në Melgushë
u shugurua me 18. qershor 2022*



Fort i dashur Imzot Angelo Massafra, të dashur bashkëvëllezër meshtarë, të gjithë ju besimtarë të dashur: e falënderojmë njëzëri Zotin që bëri të mundur ndërtimin e këtij objekti të shenjtë kulti në Melgushë.

Më duhet t'ju marr edhe pak kohë për dy fjalë para se të fillojmë këtë kremtim solemn. Meqë ra fjala për solemnitetin, falënderoj shumë Fra Vinçencin për organizimin e liturgjisë. Gjithashtu edhe Motër Valentinën me fëmijët e Melgushit dhe të fshatrave të tjerë për këngët e përgatitura.

Ky 18 qershor 2022 është shumë i veçantë për ne të gjithë të pranishëm këtu e mbase janë të tepërta fjalët në këtë ditë, por nga ana tjetër, si famullitar e kam edhe si detyrë që të bëj disa falënderime ndaj atyre bamirës të shumtë që mundësuan këtë kishë të re për Melgushin.

Po i marr gjërat në rend kohor e për këtë arsye po përmend së pari përkujdesjen e vëmendshme të Motrave Françeskane të Bamirësisë, Motër Roza e Motër Mina, të cilat ishin të parat në vitin 2017 që i vunë re dhe na i treguan shenjat e para të

përkeqësimit të strukturës së ndërtesës së kishës së mëparshme dhe të shtëpisë e tyre. Ishte heroizëm i përnjëmendte që Motrat vazhduan të banonin në atë shtëpi, deri në vitin e kaluar, kur gjendja tashmë ishte shumë e rrezikshme, me çarje të frikshme në mure e në soletë. Aq më tepër me mjetet e rënda që tashmë filluan të lëviznin pranë shtëpisë së tyre me fillimin e punimeve për ndërtimin e kishës së re.

Motrat jo vetëm na vunë në dijeni me këmbëngulje të vazhdueshme, por edhe sollën nga Italia disa ekspertë të fushës, miq të tyre, që filluan të bënin falas një punë studimi e cila zgjati rreth një vit e që, me profesionalizëm prekës, i çoi në përfundimin se shtëpia e Motrave duhej të braktisej sa më parë, kurse Kisha mund të priste maksimumi deri në pesë vite, nëse nuk do të ndodhte ndonjë gjë e papritur, siç janë tërmetet. E në fakt, në nëntor 2019 tërmeti ra. Edhe pse epiqendrën e kishte pak larg, gjendjen e strukturave e përkeqësoi mjaft.

Pas këtij studimi nga ekspertët, edhe arqipeshkvi u bind se situata nuk mund të priste më dhe se, po të shtyhej me shpresën se “ndoshta nuk



ndodh gjë”, një ditë mund të gjendeshim përballë ndonjë situatë fatale. Prandaj dua ta falënderoj sinqerisht Imzot Angelon që ka qenë aq i gatshëm në kërkimin e donatorëve të ndryshëm nëpër botë. Unë personalisht nuk mund të rri pa shtuar edhe një falënderim timin personal shumë të sinqertë për të se, me gjithë paratë që më ka rënë të kem nëpër duar në këtë kohë, ka treguar gjithnjë një besim shumë të madh e të pakufizuar ndaj meje. Vinte të shikonte ecurinë e punimeve, jepte mendime, bënte pyetje se si do të vazhdohej, por gjithnjë me shumë respekt dhe besim të dukshëm. Për këtë i jam thellësisht mirënjohës.

Duke iu kthyer rrjedhës së ngjarjeve, ka qenë befasuese përgjigjja e donatorëve që filluan të jepnin ndihmesat e tyre.

Së pari u përgjigj Propaganda Fide në Vatikan e vetëm pak muaj më pas u përgjigj me shumë bujari edhe Konferenca Ipeshkvnore e Amerikës. U mbledh kështu një shumë e konsiderueshme, që na mundësoi të fillonim menjëherë punimet në shkurtin e vitit 2021, edhe pse moti nuk na favorizonte edhe aq.

Na u desh të shpenzonim vërtetë shumë për gjetjen e terrenit të përshtatshëm, edhe pse na u desh të zbrisnim pak më poshtë se niveli i kishës së vjetër. Por nuk kishim si të bënim ndryshe.

U gëzova shumë kur më në fund, pas një muaji, i hodhëm themelet, por as që nuk e besoja se do të mund t'i vazhdonim punimet deri në përfundimin e gjithçkaje. Mendoja se së paku se hedhja e themeleve do të na ndihmonte të kishim mbështjen edhe të ndonjë bamirësi tjetër.

E një bamirës që nuk e prisja ishte edhe një biznesmen i zonës që na dhuroi krejt tullat e nevojshme për ndërtesën. Jo vetëm kaq, por ai, edhe kur ishim drejt përfundimit të punimeve, na dhuroi edhe një shumë tjetër të konsiderueshme parash për përballimin e shpenzimeve të ndryshme.

Gjatë ngritjes së mureve, më kujtohej ndërtimi i kishës së re në Rranxa e cila mbaj mend se ka qëndruar pa çati për disa vite. E, si me shaka, u thoja edhe punëtorëve se vonë do të arrinin t'ia vinim kapelën kësaj kishe. Por nuk vonoi e ipeshkvi më tha se një shoqatë kishtare nga Amerika, Papal Foundation, na kishte dhuruar aq para sa na nevojiteshin fiks për çatinë. U gëzova sa s'ka, sepse ishte si një mrekulli që na u përgjigjën e pozitivisht dhe me aq bujari të madhe. Ndërkaq nuk vonoi e edhe nga shoqata kishtare në Gjermani, Kirche in Not, na u dhuruan para të tjera.

Ishin mbledhur deri në ato çaste rreth 140 milion lekë e, me tullat e dhuruara, gjithçka dukej

tashmë më së miri. Por pas tërmetit të vitit 2019, një tjetër tërmet, edhe më i keq, goditi Shqipërinë dhe botën mbarë: rritja e shfrenuar e çmimeve. Sa për të dhënë një shembull: vetëm çatia, me gjithë tjegulla, ka kushtuar 59 milion lekë. Sikur ta kishim bërë një vit më parë, mendoj do të kishte kushtuar së paku 20 milion lekë më pak.

Por Zoti nuk na e mungoi ndihmën e tij përmes shumë njerëzve të tjerë vullnet mirë. Nga disa emigrantë në Amerikë, nga Melgushi, por jo vetëm, arritëm të mbledhim shuma jo të vogla. Pas tyre një tjetër meshtar shqiptar në Amerikë na dhuroi disa dollarë, por më tha se dëshironte të mbetej anonim. Po ky meshtar, kur u gjetëm ngushtë në fazën e përfundimit të punimeve, sërish na erdhi në ndihmë me të tjera para, aq sa na mjaftonin për ndërtimin e altarit të ri.

Një tjetër ndihmesë na erdhi nga shoqata Gjermane Kirche in Not kur na dërguan, si rrallë here, edhe një shumë të dytë. Kjo ndihmesë kaq e madhe nga Kirche in Not jam i sigurte se ka ardhur edhe falë ndërmjetësimit shumë dashamir të një meshtari gjerman, mik i imi, Dom Mark Peters, albanolog shumë i apasionuar, e që në këtë rast ka qenë edhe si garant se paratë do të shkonin aty po dërgoheshin.

Para pak javësh edhe nga arqipeshkvi i Maltës na u dërguan disa euro të tjera e, prej disa meshtarëve nga Italia, na janë dhuruar edhe disa shuma të vogla, por me zemër të madhe.

Të gjitha këto para të ardhura nga Shoqatat bamirëse, duhet theksuar se janë para të mbledhura ndër njerëz të thjeshtë, të cilët duan t'u përgjigjen thirrjeve për ndihmë të ndokujt në nevojë. Pra e kuptoni se sa të shumtë janë njerëzit që as nuk i njohim e as nuk kemi për t'i njohur fare, por që u detyrohemi kaq shumë mirënjohje që na mundësoan kishën e re! Zoti ua shpërbleftë të gjithëve me hire e bekime.

Gjithashtu ju falënderoj të gjithëve ju, banorë të Melgushit, që keni ndihmuar sipas mundësive, duke mundësuar lartësimin e këtij tempulli të lutjes.

Falënderoj edhe Dom Ardian Arrën, famullitar i mëparshëm në këtë famulli, që na gjeti disa bamirës në Itali të cilët na dhuruan pllakat që shtrojnë nga brenda kishën dhe klasat që gjenden pas.

Meritojnë shumë mirënjohje të gjithë punëtorët që kanë punuar këtu me shumë përkushtim e lodhje. Shumë herë ata kanë vendosur që të mos marrin aq sa u takonte zakonisht nga tregu i punës dhe unë personalisht u jam thellësisht mirënjohës. Pastaj edhe shumë nga tregtarët na



kanë bërë zbritjet e tyre e kjo ka ndikuar jo pak që të kursenim para për ecurinë e punimeve.

E lashë për në fund fare, por e bëra me dashje. Dua të falënderoj për zemërsisht inxhinierin Lorenc Marashi i cili ka ndjekur të gjitha punimet e bëra këtu dhe gjithë këtë e ka bërë pa marrë asnjë shpërblim. Është meritë e tij që punimet janë bërë me cilësi të madhe dhe janë ndjekur me shumë profesionalizëm. Zoti ia shpërbleftë për gatishmërinë e vazhdueshme që ka pasur duke ardhur këtu çdo javë e, në disa faza, edhe çdo ditë, apo edhe dy herë në ditë.

Duke iu afruar fundit të listës, falënderoj një tjetër biznesmen të zonës për sistemimin e oborrit të kishës. Gjithashtu falënderoj edhe bamirësin që falas bëri zbulimin e kishës kështu siç e shihni sot. Një prej banorëve të fshatit, Gjon Shpati, na ka financuar edhe ndërtimin e një truporeje të madhe të Krishtit që do ta vendosim pas pak javësh në oborrin e kishës.

E shihni pra se sa e madhe është ushtria e atyre që kanë dashur që ky vend i shenjtë të lartësohej sa më parë e që ne sot, vetëm një vit e gjysmë nga dita kur kemi filluar punimet, po e shugurojmë? Pa këtë ushtri nuk do të ishim këtu sot. Preventivi i bërë në vitin 2018, kur filluam kërkesat bamirësve, ishte rreth 200 milionë lekë, por janë shpenzuar rreth 215 milionë. Preventivit, në fakt, i kemi shtuar edhe dy klasat poshtë e një tjetër në katin e dytë, që gjenden pas kishës, e kjo na ndikuar që shpenzimet të

shtoheshin dukshëm dhe ju mund ta imagjinoni lehtë se sa do të kishte shkuar shuma që ishte dashur të paguanim me rritjen e madhe që iu bë çmimeve sikur gjithë këta njerëz vullnet mirë të mos kishin bërë pjesën e tyre.

Paratë që munguan, arritëm t'i kemi nga të ardhurat e famullisë dhe falënderoj sërish këtu ipeshkvin që të gjitha meshat shumënjëteshe na i ka kthyer që t'i përdorim për ndërtimin e kishës.

Jam i sigurt se edhe lutjet e të gjithëve kanë bërë që të na vijnë në ndihmë edhe ndërmjetësit tanë qiellorë, sidomos Shën Gjergji, të cilit sot kjo kishë po i kushtohet. Nuk po e them sa për të zbuluar gjërat, por unë i besoj vërtetë këto gjëra. Ata ndërmjetësofshin edhe që ne të jemi të vetëdijshëm se kjo kishë nuk është tempulli ynë përfundimtar, por se është vetëm shëmbëllesë e largët e tempullit të amshuar që Hyji ka përgatitur për secilin prej nesh e që Krishti na e ka fituar me Gjakun e Tij. Këtu filloftë dhe u ushqeftë jeta jonë me Zotin, që kurorën do ta marrë në Jerusalemin qiellor.

Edhe një herë, duke kërkuar falje nëse kam lënë ndokënd pa përmendur, shumë faleminderit të gjithëve.

Dom Dritan Ndoci

*Famullitar i famullisë "Shën Rroku"
Rranxa-Bushat*





NDËRVEPRIMI DHE DIALOGU JANË PJESË THELBËSORE E SINODIT

Mons. Angelo Massafra:
Përsëritja drejtuar asamblesë
Dioqezane për Sinodin

Ju uroj mirëseardhjen në këtë takim që është vetëm një etapë e ecjes sinodale që kemi ndërmarrë edhe ne në Arqidioqezën tonë, së bashku me Kishën universale.

Pas pak do të informohemi për rezultatet e takimeve të zhvilluara në zona të ndryshme baritore, të analizuara dhe të përmbledhura më pas nga Dom Marian Gega dhe anëtarët e tjerë të Komisionit të posaçëm, që gjej rastin ta falenderoj me gjithë zemër për punën e bërë dhe për atë që do të bëjë akoma.

Gjithashtu, gjej rastin t'i kujtoj vetes sime dhe juve se puna e këtij Komisioni, si edhe e të gjitha komisioneve të tjera baritore të një Dioqeze, nuk duhet të na përjashtojë nga përgjegjësia personale, duke u deleguar atyre trajtimin e argumenteve të caktuara. Madje, puna e tyre na shërben për t'u bërë më të përgjegjshëm dhe për të nxitur një ndjenjë të përbashkët rreth çështjeve baritore që trajtohen herë pas here. Pra, faleminderit përsëri për punën e bërë.

Për ta nisur këtë ditë, dua të theksoj të mirën e metodës sinodale aq të dëshiruar nga Papa Françesku dhe se, në fund të fundit, nuk është gjë tjetër përveç asaj që vetë fjala "kishë" do të thotë. Ndërveprimi dhe dialogu që përfshin metoda sinodale janë pjesë thelbësore e të qenit kishë, bashkësi njerëzish të mbledhur nga dashuria e Atit, rreth Krishtit për virtyt

të Shpirtit Shenjt. Nga ky ndërveprim dhe nga ky dialog lind, pastaj, edhe një vizion i qartë i identitetit tonë: si ai që mund të dalë nga leximi i realitetit, ashtu edhe ai ideal drejt të cilit duhet të priremi vazhdimisht.

Edhe nëse leximi i realitetit do të zbulonte pjesë të errëta, kjo nuk duhet të na shkurajojë, por përkundrazi të konsiderojmë se drita e hirit ka fuqi t'i ndriçojë edhe errësirat më të thella. Për fat të keq jetojmë në një botë që na bën të shohim më shumë anët e errëta, sesa të mirat që bëhen. Një lexim i shëndetshëm i realitetit, nga ana tjetër, është i aftë që të dallojë si të mirën, për ta përfurcuar, ashtu edhe të keqen, për ta korrigjuar.

Kjo është e mira e metodës sinodale, me pak fjalë. Por ajo duhet të bëhet një stil jetese, që vlen për çdo lloj bashkësie brenda Dioqezës, si famullitare ashtu edhe rregulltare. Ndaj duhet të jemi gati për këtë ndryshim stili, çfarëdo që do të dalë nga përmbledhja që pas pak do të bashkëndahet me ne.

Po ashtu, edhe kjo ditë uroj që të jetohet me këtë stil vëllazëror bashkëndarjeje, dialogu, ballafaqimi dhe propozimi, në mënyrë që rrugëtimi i Kishës sonë dioqezane të jetë i lidhur mirë me të tashmen dhe të shërbejë për ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë dhe gjithnjë e më të rrënjësuar në Ungjill dhe në personin e gjallë të Krishtit të ngjallur që nuk na lë vetëm, siç premtoi Ai vetë.

Ditë të mbarë të gjithëve.

SHPREHIM BESIMIN DHE SHPRESËN TONË!

Prot. 26/2022
Tiranë, 06.06.2022

Shumë i nderuar Zoti Begaj,
Në emrin tim, si Kryetar i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë edhe në emër të ipeshkvijve të Kishës katolike, si dhe të të gjithë besimtarëve katolikë në Shqipëri, Ju uroj për zgjedhjen Tuaj në detyrën e lartë të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Shprehim besimin dhe shpresën tonë se Ju do ta kryeni më së miri këtë shërbesë, që Ju është besuar nëpërmjet kësaj zgjedhjeje nga Parlamenti i Shqipërisë. Në këto momente të vështira për Evropën dhe për botën, për shkak të Luftës ende të ndezur në Ukrainë edhe të Pandemisë që akoma nuk e kemi kaluar, po ashtu edhe të problemeve të tranzicionit të tejzgjatur të shoqërisë shqiptare, urojmë që me urtësinë dhe përkushtimin Tuaj, të

Presidentit të zgjedhur të Republikës së Shqipërisë
Z. Bajram BEGAJ

jeni një element përbashkimi dhe shenjë e dukshme e unitetit të popullit tonë.

Fuqizimi i demokracisë ka në themelin e saj, si një ndër elementet përbërëse thelbësore, përkushtimin dhe qartësinë e secilit në detyrën dhe në misionin e tij. Ne Ju sigurojmë mbështetjen tonë me anë të lutjes drejtuar Hyjit dhe të bashkëpunimit për mbarëvajtjen e misionit Tuaj në shërbim të Atdheut dhe të demokracisë.

Në pritje që të takohemi sa më parë, uroj çdo të mirë për Ju dhe familjen Tuaj.

Me nderime,

+ **Mons. Angelo Massafra ofm**
Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër – Pult
Kryetar i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë



MALËSIA E DUKAGJINIT: INAUGURIMI I KUMBONARES NË GIMAJ

Një ndër zonat më piktoreske të Alpeve Shqiptare, jo vetëm për nga bukuritë e rralla natyrore me të cilat Zoti e ka bekuar, por edhe për traditat dhe kulturën e banorëve të saj është. Kjo zonë, jo pak e vizituar nga turistë të ardhur nga shumë vende të botës, ka qenë dhe është një dëshmi e gjallë e një vendi që qëndron gjithmonë ballëlartë, pavarësisht dallgëve të shumta të jetës. E them këtë pasi ngjarja e përshkruar në këtë tekst së bashku me shumë të tjera që kanë marrë jetë dhe që do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, dëshmojnë se çfarë është një jetë autentike, e cila pas betejash të shumta në fund del triumfuese. Siç dihet tashmë, një nga elementet që kanë luftuar më së shumti sistemet totalitare është religjioni (besimi), pasi ky i fundit nxit vetëdijësimin e plotë të njeriut për vlerën dhe rëndësinë që ka. Duke qenë se një gjë e tillë nuk i përshtatej këtyre sistemeve, këto të fundit janë munduar të eliminojnë rrethanat në të cilat krijohet religjioni. Ato kanë arritur të shkatërrojnë kisha dhe institucione të ndryshme fetare, por nuk e kanë kuptuar se religjioni i vërtetë gjendet në zemrat e njerëzve, e një gjë e tillë e dëshmon më së miri populli i Dukagjinit, i cili sot pas shumë dekadash, përmes investimeve dhe kontributit të tyre shprehin në një farë mënyre atë që kanë ruajtur për gjatë tërë kësaj kohe brenda zemrave. Disa nga investimet e fundit të bëra në këtë zonë janë



inaugurimi i kumbonares dhe kumbonës në kishën e Shën Rrokut në Gimaj dhe inaugurimi i trupores së Shna Ndout në qendrën e Bregut të Lumit,





pikërisht në vendin ku ka qenë më përpara.

Pas një shkëputjeje shumë-vjeçare ka rifilluar kremtimi i meshës në këtë kishë, e cila së bashku me kishat e tjera filiale dhe kishën famullitare të Ngjitjes së Zojës në Qiell në Theth ka kaluar në administrimin e fetërve. Famullitari i parë ishte fra Aurel Gjerka, i cili është ndjekur nga famullitari i tanishëm fra Gazmend Tinaj. Inaugurimi i kumbonares dhe kumbonës e cila kjo e fundit u financua nga Gjovalin Biga, është bërë më 30 prill 2022 në meshën e udhëhequr nga arqipeshkvi i Arqipeshkvisë imzot Angelo Massafra. Riti i



bekimit të kumbonares është bërë në fillim të kremtimit eukaristik, i cili për shkak të numrit të madh të pjesëmarrësve është zhvilluar në oborrin e kishës. Bashkëkremtues në meshë ishte fra Gazmendi, famullitari i famullisë së Zojës së Shkodrës dom Vlash Palaj, fra Ndue Toplana dhe dom Anton Kodrari. I pranishëm ishte diakoni Marjan Gjinesha, i cili është bir i këtij vendi. Ndër pjesëmarrësit e shumtë mund të përmendim prefekten e qytetit të Shkodrës zonja Majlinda Agoni, përfaqësuesin e shoqatës “Nikaj Mërtur” z. Mhill Gecaj kryetarin e shoqatës atdhetare “Dukagjini” z. Ndue Samaj.

Me këtë rast, duhet përmendur, pjesëmarrjen e bamirësve të shumtë vendas dhe zona si dhe donatorëve që jetojnë e veprojnë në diasporë që ndihmuan në këtë projekt. Nga diaspora duhet përmendur kontribuuesin më të madh, Vat Biga me familje e farësin e tij si dhe Shoqatën “Bajraktari” më koordinator Ilir Biga të cilët nuk i harrojnë rrënjët e tyre.

Në fund të meshës fra Gazmendi falënderoi personalitet politike dhe fetare të pranishme, fra Aurelin për punën e bërë si famullitar para tij, investuesit, bamirësit dhe të gjithë të pranishmit që ishin bashkuar në ato momente gëzimi.

Pjesa e dytë ka vazhduar në zonën e Bregut të Lumit ku është bërë inaugurimi i trupores së Shna Ndout, të punuar me shumë dashuri dhe përkujdesje nga z. Zef Muri, të transportuar nga forcat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të financuar nga shaljanët e diasporës. Pas bekimit të trupores nga imzot Massafra janë bërë disa përsëritje nga

të pranishmit, ndër të cilët edhe dom Antoni, z. Mhill, z. Ndue, zonja Majlinda dhe fra Gazmendi. Përveç bekimit të trupores është bërë edhe bekimi i urës së rikonstruktuar nga bamirësit dhe investuesit vendas. Në këtë ditë nuk kanë munguar as dhuratat. Ipeshkvit dhe fetërve u janë dhuruar dy libra shumë të vjetër fetarë: njëri është meshar françeskan, i cili është ruajtur që nga viti 1948, ndërsa tjetri është Bibla në gjuhën latine, e cila ka një vlerë të madhe historike. Pas përsëritjeve të bëra, të gjithë janë bashkuar në Ndërlisaj, ku kanë pasur drekën vëllazërore.

Teksti:

Fra Lorenc Pepniku



NDËRROJ JETË: ATE DEDË GJOKA, O.F.M.
(21 mars 1977 – 03 qershor 2022)



P. Deda lindi në Kir të Dukagjinit, më 21 mars 1977. Në vitin 1995 erdhi në Seminarin Minorë të Fretërve në Shkodër, ku edhe mbaroi shkollën e mesme tek At Pjetër Mëshkalla.

Ke pranuar në noviciatin (rishtarinë) e Fretërve Minorë më 28.08.1999 e pasi mbaroi vitin e rishtarisë, dha kushtet e para më 16.09.2000.

Kreu në Shkodër studimet filozofike dhe teologjike në vitet 2001-2006.

Kushtet e Përrjetshme në Urdhrin e Fretërve Minorë i dha më 08.09.2004.

Diakonatin e mori më 14.05.2005.

Meshtar u shugurua më 29. 06. 2006.

Në vitin 2006 ke anëtar i bashkësisë në Gjuhadol, Rektor i Seminarit të Fretërve Minorë, Zv. Ekonom i Provincës.

Në vitin 2007, kishte detyrën e Ekonomit në Kuvendin e Gjuhadolit.

Në vitin 2008, anëtar i bashkësisë tek Arra e Madhe, duke mbajtur detyrën e Përgjegjës të Konviktit si edhe të Zv. Famullitarit. Po kështu në këtë vitin ai ke edhe Zv. Guardian në Gjuhadol.

Në vitin 2009 ishte Drejtor i shtëpisë filiale edhe i Konviktit tek Arra e Madhe. Gjatë këtij viti ushtroi detyrën e Zv. Guardianit në Gjuhadol dhe të Zv. Ekonomit Provincial. Ishte Famullitar i Kishës së “Zojës Ruzare”.

Po kështu nga viti 2009-2012 ke Definitor Provincial. Mbuloi edhe këto detyra: Drejtor i shtëpisë filiale dhe i Konviktit tek Arra e Madhe, Zv. Guardian në Gjuhadol, Zv. Ekonom Provincial si dhe Zv. famullitar në Famullinë “Zoja Ruzare”.

Në vitet 2013-2015 u transferua në Kuvendin

Françeskan të Lezhës dhe mbajti këto detyra: Anëtar i bashkësisë në Lezhë, Zv. Guardian, Anëtar i ekipit për pastoralin e thirrjeve si dhe Administrator i Famullisë Troshan-Fishtë.

Në korrik të vitit 2015 deri në vitin 2021 u transferua pranë Kuvendit Françeskan “Zoja Ruzare” tek Arra e Madhe, ku dhe u caktua si Zv. Guardian dhe Zv. Famullitar.

Në mars të vitit 2021, pas përkeqësimit të gjendjes së tij shëndetësore kaloi në infermierinë provinciale tek Arra e Madhe, ku deri në momentet e fundit të jetës i shërbyem përzemërsisht prej fretërve, murgeshave dhe familjarëve.

Qysh në vitin 2007 iu shfaqën shenja të sëmundjes duke fillua një lloj paralize, e cila erdhi e u përkeqësua deri sa e paralizoi krejtësisht. Nën kujdesin e veçantë të fretërve, të miqve dhe të bamirësve bëri shumë kura mjekësore, por që i pamundur shërimi nga kjo sëmundje.

Ishte i dashur dhe i komunikueshëm me të gjithë, i urtë e i përvuajtur, tipike e bijve të Shën Françeskut. I zellshëm në predikim dhe në kryerjen e detyrave që i kenë caktua prej Provincës Françeskane Shqiptare.

Mbasi mori Sakramentin e Vajimit ndërroi jetë në Kuvendin e “Zojës Ruzare”, më 03 qershor 2022 në orën 22:30 minuta.

Salikimi u bë me 6 qershor në Kishën e Shën Françeskut në Gjuhadol morën pjese shumë Ipeshkvij, meshtarë dhe rregulltarë dhe shumë besimtare.

Zoti e Pastë në Parriz.



MISION HISTORIK PËR BASHKIMIN E TROJEVE

*Përmbyllen të tre sesionet shkencore për Mustafa Krujën,
Mons. Dr. Zef Oroshin dhe kapidan Mark Gjon Markun.*

Ky rrugëtim edhe përkundër natyrave tjera është duke ndjekur rrugën shkencore, misionin dhe vizionin historik për bashkimin e Trojeve shqiptare në një shtet të përbashkët në Shqipërinë Etnike.

Ndaj edhe me datën 12 qershor 2022, në ambientet e hotel “Luxori” pikërisht në Prizrenin e Besëlidhjes Shqiptare, është mbajtur Sesioni shkencor dedikuar firmëtarit të Deklaratës së Pavarësisë të Shqipërisë dhe Kryeministrit të Shqipërisë Etnike Mustafa Kruja. Ndërsa të nesërmen apo me 13 qershor 2022, Shoqata e Intelektualëve “Trojet e Arbrit” mbajti Sesionin tjetër me radhë në Lezhë kushtuar, Mons Zef Oroshit.

Kjo shoqatë me 14. Qershor 2022, po ashtu në Lezhë, organizoi një Akademi tjetër përkujtimore me rastin e 76 – vjetorit të vrasjes së komandantit legjendar të Shqipërisë Etnike Kapidan dr. Mark Gjon Marku, duke përmbyllur ditën e tretë të “Trojeve të Arbërit” e cila është mbajtur në Qëndren Kulturore për Fëmijë “Gjergj Lacaj” në Lezhë.

Me këtë rast po botojmë kroniken rreth mbajtjes së Konferencës për Mons. Zef Oroshin.

Mons. Dr. Zef Oroshi

Ky Sesion shkencor mons.dr Zef Oroshit, është mbajtur në sallën moderne të konferencave të Hotel “Lisus” në Lezhë. Sesion dedikuar mons.dr. Zef Oroshit, i cili ishte Themeluesi i Kishës Katolike “Zoja e Shkodrës” në New York njëkohësisht ishte një poliglot e udhëheqës i luftëtarëve të maleve me emrin Rozafati që luftonte për të drejtat dhe çlirimin e Shqipërisë kundrejt hordhive komuniste enveriane. Ishte moderatorja studentja znj/sha Foniqi, e cili e hapi Sesionin shkencor ndaj i ftoj të pranishmit që në shenjë nderi ta nderojnë himnin e flamurit kombëtar. Në vazhdim ishte një deklamim poetik nga Martin Dedaj...

Paraprakisht me fjalë përshëndetëse në emër të familjes së mons. dr.Zef Oroshit e bëri, studenti Ervis Prendi. Kënga : “Thrret Prizreni mori



Shkodër” – kënduar nga Mirak Ukaj ishte pjesë e kesaj ngjarje.

Kjo ngjarje madhështore që drejtohej nga mr. sci. Nue Oroshi, kryetar i “Trojeve të Arbërit”, morën pjesë edhe shumë mysafirë, klerikë, studiues dhe historian, publicist si dhe biografi dhe miku me i afërt i mons. dr. Zef Oroshit, nga Nju Jorku, z. Tome Mrija i cili e bëri fjalën e hapjes me këto fjalë: Në fillim dua të falënderoj Kryesinë e Shoqatës sonë, të cilët me nderuan shumë, duke më lënë të bëj hapjen e këtij Sesioni Shkencorë kushtuar figurës së shquar të klerikut katolik mons. dr. Zef Oroshit. Shoqata “Trojet e Arbërit”, sot po ia kthen një borxh të vogël një meshtari të madh, që gjithë jetën ia kushtoi trinit: Fe-Atdhe-Përparim. Në mënyrë telegrafike po bëj një parakalim të shpejtë të jetës së meshtarit tonë ndër vite plot fitore dhe suksese, në të mirë të trojet shqiptare për shumë dekada. Një ndër meshtarët



e kohës dom Engjell Serreqi S.J., që ishte meshtarë në Mirditë, dhe njëkohësisht ish pjesëtarë i Kuvendit të Jezuitëve në qytetin e Shkodrës, kishte venë re qysh herët zgjuarsinë dhe talentit e Oroshit, qysh kur ai ishte në shkollë fillore. Më vonë, ai u interesua shumë për këtë të ri, dhe personalisht e dërgon në qytetin e Shkodrës, ku e regjistron në Seminarin e Kolegjit Pontifikal. Studenti i ri i teologjisë dom Zef Oroshi, mbasi përfundon me shumë sukses studimet e larta shugurohet si meshtar në Romë të Italisë në vitin 1940. Bariu ynë po atë vit kthehet në vendlindje e tij Mirditë, që e deshi shumë. Abati i



Mirditës imzot Frano Gjini asokohe, i cili ishte mirinformuar nga shumë meshtarë të dioqezave të Mirditës për të riun meshtarë dom Zef Oroshin, si një njeri me kulturë bashkëkohore dhe shumë i përgatitur. Abati i Mirditës imzot Frano Gjini, për të rritur cilësinë intelektuale të Abacisë së vet, me njerëz energjik dhe të shkolluar me dituri bashkëkohore e emëron menjëherë meshtarin e ri dom Zef Oroshin si Sekretar dhe këshilltar të Abacisë së Mirditës (në ditët tona kjo detyrë është e barabartë me detyrën e Vikarit të Përgjithshëm, shënimi im T. M.), dhe meshtarë në kishën e Shën Kollit në Spaç të Mirditës.

Duhet thënë, se limani i fundit ku meshtari i ri Oroshi jetoi dhe veproi si bari shpirtëror për grigjën e vet mirditas, ishte kisha e Shën Magdalenës në Ungrej të Mirditës dhe ku ai rrethohet nga forcat ushtarake komuniste. Meshtari asokohe po thoshte meshën e së dielës për besimtarët e vet. Kisha, ishte e rrethuar nga forcat e sigurimit komunist, të cilët kontrollonin lëvizjet e të gjithë njerëzve, që hynin dhe dilnin në kishë. Fatmirësisht, ai i shpëtoi rrethimit dhe iku në drejtim të maleve të Mirditës... Dom Oroshi qëndron për 8 muaj në malet e Mirditës, duke qenë komandant i forcave nacionaliste dhe njëherazi si atë shpirtëror, duke rritur lart moralin e nacionalistëve patriotë, që me armë në dorë po luftonin kundër komunizmit të zi, që kishte pushtuar vendin e shqiptonjave. Në esencën e jetës së meshtarit Oroshi, ishte se themelet e shëndosha atdhetare dhe fetare bariu ynë nacionalist i vuri në truallin e njohur për fe e atdhe më Mirditën e tij, për t'i vazhduar më vonë edhe më me intensitet dhe lartësi të mëdha në kontinentin e largët të Amerikës së Veriut, ku kulmoi në nivele të reja si një ndër personalitetet më të shquara atdhetare dhe fetare, në

tokën e bekuar të ShBA-së, duke themeluar kështu Kishën e Parë Katolike Shqiptare “Zoja e Këshillit t'Mirë” në Bronx, New York, e cila sot vijon me emrin Zoja e Shkodrës, në Hartsdale NY. Në lidhje me këtë çështje shumë të rëndësishme të histerisë së klerikut katolik mons. dr. Zef Oroshit në Shqipëri deri më sot nuk është bërë asnjë hulumtim dhe studim serioz, kur dihet se për këtë figurë në Arkivin Qendror të Shtetit në Shqipëri ka me qindra dhe mijëra dokumente, që i përkasin viteve 1945-1989 dhe vazhdimisht është shkruar zi e më zi për meshtarin tonë.

Mbi veprimtarinë e tij aktive, gjatë periudhës që ishte në emigracion në Evropë dhe SHBA, meshtari Oroshi e la të dokumentuar nëpër shumë revista dhe gazeta të botës shqiptare në diasporë dhe posaçërisht në revistën kulturore fetare “Jeta Katolike” (1966-1989) e themeluar dhe drejtuar nga vetë ai. Unë nga zemra, ftoj të gjithë ata dashamirë të historisë dhe kulturës shqiptare, që duan të hulumtojnë dhe botojnë punimet e tyre serioze historike mbi jetën dhe veprën e meshtarit të shquar mons. dr. Zef Oroshit, për ato 11 vite të pandriçuara në vendlindjen e tij në Mirditë, unë ua mundësoj botimin e librave të tua. Ndërsa në vazhdim tha se në një shkrim analitik me titull: “Homazh për Monsinjon dr. Zef Oroshin”, autori Bep Kuqani me banim në SHBA, ish i burgosur politik në kohën e regjimit komunist në Shqipëri, në lidhje me monografinë time kushtuar: “Monsinjon Dr. Zef Oroshi një jetë e shkrirë për fe e atdhe” (Shkodër, 2009), në përkujtim të 20-vjetorit të kalimit në amshim, ndër të tjera, ai shkruan me hollësi disa detaje të rëndësishme të veprimtarisë patriotike me pushkë në dorë të meshtarit antikomunist dom Zef Oroshi. Ai, kujton: “...E tash në lidhje me një shënim të Z. Ndue



Melyshi, citue në faqen 53, ku thuhet: “Meqenëse ishte Komiteti klandestin, nuk mund të zgjidhej kryetari me vota të lira të popullit, prandaj anëtarët në brendësinë e Komitetit caktojshin një kryetar...”, dishroj të plotësoj këtë mendim, tue shtue, se në “brendësinë e këtij Komiteti”, kje zgjedhë si Kryetar Dom Zef Oroshi dhe Sekretar Jak Perjaku, i cili, kje vra në mal, në përpjekje me forcat e ndjekjes të Sigurimit. Këtë ma ka thanë përveç të tjerëve, që do t'i përmendi ma poshtë, edhe vetë i vëllai: Gjon Perjaku, që u kap n'atë përpjekje, i plagosun rëndë dhe me të cilin kam ndejtë në burgun e Burrelit. (Deri në vitin 2005, ka kenë gjallë e shendosh, që e kam takue në Shkodër dhe uroj që të jetë edhe tash po ashtu).

Veç kësaj, kam pasë rastë me njohë personalisht edhe katër antarë të këtij Komiteti, nga të cilët për Karlo Çobën, avokat, i biri i Ndoc Çobës, që ka kenë Kryetar i Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtar dhe Sulë Hafizin, Kryemyfti i Lezhës, nuk ekam ditë se ka kenë Antar i Komitetit të Maleve; ndërsa për Haki Bushatin, i vëllai i ish – Kryeministrit Maliq Bushati, që u pushkatue bashkë me At Anton Harapin O.F.M. dhe Lef Nosin dhe Ndrek Kakarriqin e kam dijtë dhe, edhe këta më kanë thanë se “kena pasë për Kryetar Dom Zef Oroshin”. ...Për Dom Zef Oroshin, duhet dijtë edhe kjo: Qysh nga dita e arratisjes, që hoqi veladonin e doli në mal, e deri që iku në Jugosllavi, banorët e Mirditës dhe të malësisë së Lezhës e kanë njohë ma fort se prift, si Kryetar të Komitetit të Maleve, si organizator i “Çetave të Shpagimit”, si luftëtar shumë trim dhe si antokomunist i vendosun.



Kam mendimin, se këtë anë të aktivitetit të tij antikomunist në malet e Mirditës, nuk ka dashtë me e ekspozue para publikut shqiptaro-amerikan kjoftë për modesti, kjoftë edhe pse nuk përputhej me veladonin e një prifti dhe këtë e ka mbajtur të mbyllun vetëm mbrenda një rrethi shumë të ngushtë bashkëluftarësh, ku me siguri duhet të ketë kenë edhe Z. Ndue Melyshi. Por kjo nuk ia ulë aspak vlerën, sepse nuk asht i pari prift shqiptar, që ka luftue me armë në dorë kundër anmiquve të vendit dhe të fesë.” (Bep Kuqani, White Plains, New York). Një mëngjes të bukur pranvere, në muajin e luleve shumëngjyrëshe të majit të vitit 1982, së bashku me imzot Oroshin, prof. Zef V. Nekën, udhëtuam me makinë nga New York në Boston, Massachusetts, për të takuar disa miq të vjetër vatanë, e posaçërisht biznesmenin e suksesshëm dr. Anthony Athanas. Dy profesorët, Oroshi dhe Neka, ishin ulur në ndenjësën mbrapa dhe po kuvendonin shtruar, ndërsa unë atë ditë isha shoferi i tyre. Pas një pauze dhe me natyrën e qetë, që e pushtonte, kur binte fjala për artin dhe letërsinë shqipe, Imzoti, i zhytur thellë në mendime për temën që po diskutonin, i përgjigjet shkurt e saktë bashkëbiseduesit: “Atë e kam mendue edhe vetë. Koha, mik i dashtun, nuk kam shumë kohë të lirë për ta rimarrë “Çohajen” në dorë punimin tim modest.” Sërish prof. Neka, që ishte shumë i impresionuar nga “Çohaja”, i drejtohet autorit: “Sa bukur e keni thurur. Përshkrimet tuaja mbresëlënëse më kanë tërheq për forcën e pendës në përshkrim. Unë kam kja si fëmi për atë vend, që po e dëshirojmë për së gjalli. Ndoshta, ai regjim i djallit nuk do të na japë mundësinë të kthehemi e të çmallemi me truallin dhe familjet tona, se çdo ditë po plakemi.” Shkrimtari Oroshi, iu përgjigj: “Fajin e kemi vet, e ma së shumti na klerikët, që qendrum pasiv e nuk e organizuem popullin, që t'ngrihej në kamb i madh e i vogël, në Veri e Jug të Shqipërisë, si ortek i madh bore e t'luftonte atë murtaj, që na shkatërroj n'temel.” Profesori, që po e dëgjonte me vëmendje të madhe, u kthye nga Monsinjori dhe me një shikim qortues, por dhe me humor të lehtë, shtoi: “I dashtun mons. Zef! Tash, nuk je tuj folë si meshtar. Krishti, ka thanë: “Nëse dikush të bjen në njenen faqe, ktheja edhe tjetren.” Oroshi, sqaron prof. Nekën, me një idhnim të thellë për komunizmin në Shqipëri, duke thënë: “Jo more Zef i dashtun, Krishti nuk e ka thanë se, nëse e ke lexue me kujdes pjesën, kur Krishtit i shkuen për t'ba tregti në Shtpinë e Zotit, ai e rroku kamxhikun e i mori përpara me fshikullim të gjithë... Djalli i mallkum shfrytëzoi mirësinë e profesionin tonë. I përdori edhe priftin me djallzi, që t'i dorëzojnë burrat ma të mirë në besë të Zotit. Po ku ka besë djalli i mallkum!? Na klerikët në Mirditë nuk punuem shumë për organizmin e popullit, kundër kuçedrës komuniste, që nuk njeh as fe as atdhe. Ky asht faji jonë, duem apo nuk duem na me e pranue. Kur Kapidani Mark Gjomarku i priu popullit me gjoks,



kundër asaj mortaje të përbindshme, ishte dasht që edhe na klerikët, të tanë bashkë, me e ndihmë në rrugën fisnike qëllimpirë, për çlirimin e Atdheut nga komunizmi bolshevik. Prandej jemi, ku jemi tash...!?” Monsinjon Oroshi, fliste me qetësi dhe gjithë që ishim të pranishëm në makinë e dëgjonin me shumë vemendje. Ndër të tjera, ai tregoi një episod historik të përjetuar:

“Më kujtohet një rast në Abaci të Mirditës, ku ishim fut thellë në bisedë me Abatin mons. Frano Gjini (1886-1948), për ato ditë të zymta, që ishim tuj perjetue: të zente terri e s'dijshim a të çel nadja. Ashtu siç ishim në dritë të qirit, sa kishte ra terri i mramjes, papritur u dëgjuen dy trokitje të lehta në derë. Menjherë u ngrita dhe hapa derën. Aty shoh Kapidan Llesh Gjonmarkun vetë të tretin. U them urdhnoni e hyni brenda dhe mirë se ju ka prue Zoti. Kapidani i porositi dy shoqnuesit e tij të qëndrojnë tek dera dhe vetë hyni brenda. Ai u përshëndet me Abatin Frano Gjini, tuj i thanë: “Abat, unë kam ardh me ju thanë se situata këtu me këto bisha të egra komuniste, që nuk njohin fe as atdhe, nuk asht e mirë dhe po druj se mos po ju ndodh ndonji e papritur këtu në Mirditën tonë. Na, me nacionalistët anti komunist të maleve, kemi mundsi që t'ju largojmë shndosh e mirë përkohsisht jashtë vendit, sa ta çlirojmë vendin nga komunistët, na prap ju kthejmë këtu në Abaci. Abat Gjini nuk iu përgjigj pyetjes së Kapidanit, por vetëm si shej falënderimit i buzqeshi lehtë. Kapidani u ngrit në

kamb, i shtrengoj dorën Abatit tonë, tuj i thanë, se brenda tre ditëve do të vijmë prap t'ju takojmë. Këto ditë rrini të qetë, se na keni ketu rrotull dhe e vëzhgojmë me shumë kujdes situatën. E përçolla deri në oborr Kapidanin dhe shoqnuesit e tij, tuj u dhanë bekimin tim. Mbas atyne fjalëve të Kapidanit, u ktheva i gëzueshëm në çelë, ku i them Abatit, se unë po e shoh fitoren kundrejt kësaj mortaje. Dhe Abati, me një qetësi karakteristike mu drejtue me këto fjalë: “Dom Zef, për Kapidanin edhe vdekja asht fitore.

Ky ka vendos të luftoj deri në frymën e fundit. Zoti ju ndihmoftë këtyne trimave të lirisë, që po sakrifikojnë rininë e tyne.” Unë prap i drejtohem Abat Gjinit, se Kapidan Llesh (Aleksander) Gjonmarku e pat mirë që ju tha të largoheni nga Shqipëria, se komunizmi ka vendos me na vra të tanve. Por Abati i ynë, tha se nuk mendoj të largohem nga Shqipëria dhe që as më takon mue në këtë moshë si zot shtëpie që ta la Mirditën dhe grigjen vetëm në këto ditë të vështira për të gjithë ne. Ime asht për ju të rijs dom Zef, që jeni të zot ti përballoni jetës së malit dhe klimës së ashpër të maleve tona me bor dhe acar.

Ju duhet të largoheni dom Zef, sepse komunizmi e ka marrë të gjithë vendin dhe po ban krime të përbindshme mbi popullin shqiptar dhe klerin katolik. i madh e din se sa ka me zgjat kjo mortaje komuniste në trojet tona. Ju duhet të largoheni për ti dëshmue botës krimet që janë ba në tokën tonë martire.

Detyra e juaj asht që një ditë të riktheheni në trojet e Arbrit, në Mirditën legjendare, ma të përgatitun që t'i ndërtoni nga themelet rrënojat, që po ban çdo ditë komunizmi i zi.

Ju duhet me ba presion ne vendet perëndimore, ku ju do të jetoni, që të rrëzohet komunizmi tek na. Tregoni botës së shqiptarët nuk e duan këtë rregjim gjakpirës bolshevik rus...” Monsinjori e kreu me sukses porosinë e Abatit të Mirditës. Tha në fund të fjalës së tij të hapjes, studiuesi Tomë Mrijaj.

Njëkohësisht morën pjesë dhe me nga një fjalë rasti janë paraqitur, dom Anton Kçira e studiuesi dom Nikë Ukgjini (i cili është edhe nismëtar për vëndosjen e bustit të dom Zefit në Lezhë) si dhe kryetari i Lezhës, z. Pjerin Ndreu, i cili veq tjerash edhe e përshëndeti me një fjalë rasti veprimtarin në fjalë të organizuar, duke kujtuar Mons. Zef Oroshi, themeluesi i bashkësisë së parë katolike shqiptare në SHBA.

Pjesa Shkencore vazhdoi me kumtesat tjera nga studiuesit të pranishëm.

Pas përfundimit të Sesionit një delegacion i “Trojeve të Arbërit” qe kryesohej nga Tomë Mrijaj (i cili i parapriu delegacionit me një buçet lulesh të freskëta) në përcjellje të referuesve shkencor, si dhe miq dhe familjarë të mons. dr. Zef Oroshit, të cilët kanë bërë homazhe pranë bustit të mons. Oroshit, bust i cili qe inauguruar me 13 dhjetor 2021 në Lezhë.

□



Frank SHKRELI
New York

60-VJET NGA THEMELIMI I LIDHJES KATOLIKE SHQIPTARO-AMERIKANE NË NJU JORK

(Pjesa e parë)

“Jemi një shkëndi e vogël, që me ndihmë të Zotit do bahemi dritë e madhe, me shëndritë dhe votrat e errësue me në Atdhe.” - Dom Zef Oroshi, New York, 1962

Të dashur e të nderuar klerikë, Shkelqësi Imzot Rrok Mirdita, Arkipeshkëv i Tiranë-Durrësit Dom Pjetër, Dom Viktor, Dom Marjan... të nderuar zonja e zotëri, anëtarë të vjetër e të ri të famullisë Zoja e Shkodrës, miqë e dashamirë. Si njëri që ka shërbyer si Sekretar i Lidhjes Katolike Shqiptaro-Amerikane (LKSHA) dhe si anëtar i Këshillit Redaktues të organit të LKSHA në fillim të 1970-ave, e ndjejë veten të nderuar me ftesën për të thënë dy tri fjalë dhe i privilegjuar që jam këtu sot për të shënuar këtë datë historike - jo vetëm për Kishën Katolike Shqiptare në mërgim, por edhe për Kishën e shumë vuajtur në Shqipëri dhe në të gjitha trevat shqiptare - për të shënuar 50-Vjetorin e themelimit të Lidhjes Katolike Shqiptaro-Amerikane, (LKSHA) më 16 Qershor, 1962.

Është këjo një datë historike, pasi i parapriu asaj që sot është famullia e parë katolike shqiptare në Amerikë, Famullia e Zojës së Shkodrës këtu në Hartsdale të Nju Yorkut, dhe në të njëjtën kohë shënon fillimin e një veprimtarie të larmishme fetare, kombëtare, gjuhësore e kulturore për komunitetin shqiptaro-amerikan. Ideja largpamëse e krijimit të Lidhjes Katolike Shqiptaro-Amerikane ishte e meshtarëve të atëhershëm të komunitetit katolik, Dom Zef Oroshi dhe At Andru Nargaj, të përkrahur nga një grup i vogël por entuziast bashkpuntorësh, disa prej të cilëve janë këtu, të pakën një e di se është këtu, Z. Tonin Mirakaj.

Për qëllime historike, meriton të përmendet fakti se në mbledhjen e parë të përgjithëshme të Lidhjes Katolike Shqiptaro-Amerikane u zgjodh Këshilli i parë prej shtatë anëtarësh, e që përbëhej prej Dr. Enrik Gurashi, Kryetar, Tonin Mirakaj, Sekretar, Loro Stajka Arkatar dhe anëtarët Zef Çupi, Mark Bajraktari, Zef Pashko Deda dhe Zef Hasani. Me këtë rast dëshiroj të falenderoj njërin prej këtyre aktivistëve dhe anëtarëve origjinal të LKSHAs, Z. Tonin Mirakaj për ndihmën që më dha - me dokumentacion dhe dëshmi personale, me burime të dorës së parë, në rrëfimin e historisë dhe të veprimtarisë së Lidhjes Katolike gjatë 50-vjetëve të kaluara, veprimtari këjo në të cilën, në një mënyrë ose në një tjetër, ai ishte vet pjesëmarrës i drejtë për drejtë.

Anëtarëve të Lidhjes Katolike Shqiptaro-Amerikane u lëshohej një librezë (si kjo, të cilën unë e ruaj qysh se jam bërë anëtar me 8 Mars, 1971), me një kuotë anëtarësie prej një dollari në muaj. Si anëtar i denjë i Lidhjes Katolike me qëllimin përpara, me moton e punës për objektivin e rëndësishëm në të ardhmen “Për Fe e Atdhe”, të lidhura e të bashkuara me unazën “Përparim” trashëguar nga para-ardhësit



Kisha Katolike Shqiptare “Zoja e Këshillit të Mirë” në
4221 Park Avenue, Bronx, New York

kishtarë atdhetarë shqiptarë, - çdonjëri që dëshironte të bëhej anëtar i kësaj lëvizjeje të re në Amerikë, vullnetarisht i vënte vetes detyrë për të qenë: a) “Katolik i mirë, praktikues i fesë; b) Shqiptar Amerikan i ndershëm; c) Vijues i Traditave të mira Kombëtare, të gërshtueme me kulturën e shëndoshë perëndimore-amerikane.” Themelimi i LKSHA dhe i kishës eventualisht ishte më urgjent, po të merrej parasysh në atë kohë politika e regjimit komunist të Tiranës kundër Kishës Katolike, që kishte në plan të zhdukte të gjitha fetë, por sidomos e kishte ferrë në sy klerin katolik, të cilin brutalisht e vrau, e burgosi dhe e torturoi deri në zhdukje. Mbylli kisha e xhamia, dhe si asnjë shtet tjetër në botë, komunistët shqiptarë morën vendimin absurd me shpalljen e Shqipërisë shtetin e parë ateist në botë, duke ndaluar me ligj edhe të Madhin Zot. Themelimi i LKSHAs u bë me vetdije të plotë nga klerikët Dom Zef Oroshi dhe At Nargaj me bashkpuntorët e tyre të ngushtë se sipas fjalëve të At Shtjefën Gjeçovit, “Atdhetarë vllazën, mos kjoftë thanun prej kujt se pa besim të vërtetë, mund të bahena atëdhetarë të vërtetë! Ku t’ zhduket emni i madhnueshëm i besimit, mos pyetni për atë komb, se nana e zezë do ta haje, e vendin e vet e qet në flakë... dhe se ai që përbuzë besimin, i del i pabesë si besimit si atdheut...pasi ata që punojnë këso dore nuk kanë farë dashnije as për njënin as për tjetrin...”

Lidhja Katolike e krijuar në bazë të parimeve të lartpërmendura, por pa qenë pjesë e asnjë grupimi politik, favorizonte dhe vazhdon edhe sot të bashkpunojë me çdo grup a individ që përpiqet t’i shërbejë interesave të Atdheut dhe kombit shqiptar pa dallim feje e krahine. Ajo fillimisht përbëhej nga anëtarë të ardhur nga Shqipëria e Veriut, shumica të arratisur për të shpëtuar nga këthetrat e komunizmit, të ardhur nga malet e nga fushat, nga trojet shqiptare anë e



mbanë Ballkanit, ruajtës të traditave tona shekullore, por dhe njerëz të shkollës. Vështirësitë ishin të mëdha, por një ndër hapat më energjetikë dhe frymëzues të Dom Zef Oroshit ishte apeli që ai i bëri, më 1968, të gjithë komunitetit shqiptaro-amerikan pa dallim feje, krahine a ideje që të përkrahnin krijimin e një qendre fetaro-kombëtare. Kësaj thirrjeje iu përgjigjën shqiptarët katolikë, muslimanë e ortodoksë, me ndihma morale dhe materiale, duke shënuar si gjithmonë një dëshmi të gjallë e konkrete tolerance, bashkpunimi e vëllazërimi midis shqiptarëve.

Duke folur për përpjekjet vendimtare të krijimit të qendrës së re, Dom Zef Oroshi pat thënë se kishte mësuar nga përvoja e Peshkop Fan Nolit vite më parë dhe se ajo përvojë e kishte bindur atë, se nëqoftse komuniteti shqiptar në Amerikë nuk duhej të shkrihej - duke humbur gjuhë, kulturë e tradita - atëherë ishte e nevojshme ndërmarrja e çdo sakrifice për të përballuar çdo sfidë e çdo pengesë për themelimin e qendrës katolike.

Ky përvjetor ka një rëndësi historike, pasi shënon fillimin e një fushate që pat mbjellë farën e parë duke mbledhur fillimisht 4000 dollarë për blerjen e Qendrës Katolike Shqiptare, e që tre vjetë më vonë u pasua me botimin e revistës Jeta Katolike Shqiptaro-Amerikane, pasi Lidhja Katolike kishte nevojë për një botim zëdhënës, por për më tepër këjo ishte edhe revista e vetme katolike shqiptare në botë, që shërbeu për të mbajtur gjallë lidhjet me të afërm dhe me të largët. Para se të fillonte botimi i revistës Jeta Katolike, popullarizimin e Lidhjes së re në komunitet dhe më gjërë, e kishte marrë përsipër Tonin Mirakaj me artikujt e tij të botuar në gazetën Shqiptari i Lirë. Kështuqë në një mënyrë Tonini, si sekretar i parë dhe gazetari Shqiptari i Lirë dhe Dielli ishin propaganduesit e parë të veprimtarisë fetare dhe patriotike të Lidhjes së re Katolike.

Megjithëse gjatë kësaj periudhe, shërbimet fetare të komunitetit katolik shqiptar bëheshin nepër kisha të ndryshme amerikane, puna e rëndë e Kryetarit Dom Zef Oroshit dhe anëtarëve të Lidhjes Katolike Shqiptaro-Amerikane si dhe serioziteti i kësaj nisme të komunitetit të vogël katolik, 50-vjetë më parë, u kurorëzua natën e Krishtlindjes të Dhjetorit 1969, kur u tha mesha e parë në Qendrën Katolike Shqiptare në 4221 Park Avenue të lagjës Bronks. Kryetari i Lidhjes Katolike Dom Zef Oroshi, në predikimin e tij me këtë rast përshëndeti grigjën e tij duke u thënë: "Mirë se u pruni Zoti në shtëpinë tuej. Siç pat thenë vite më parë, në krijimin e Lidhjes Katolike me 1962, Dom Zefi rithkesoi edhe me këtë rast se "Këjo sot është një shkëndi e vogël që me ndihmë të Zotit do të bahemi dritë e madhe, me shëndritë edhe votrat e errësue me Atdhe" – duke shtuar se "Rruga e jonë është dhe mbetet ajo e Krishtit: drejtësi, dashuni e paqë për gjithkënd dhe me gjithkënd."

Kishës së parë katolike shqiptare në Nju Jork, me dekret të Arqipeshkvit të atëhershëm të Nju Jorkut, Eminences së tij Terence Kardinal Cooke, iu njohën të gjitha të drejtat si famulli e plotë, me përjashtim të emërtimit famulli, përfshirë të drejtën e rezidencës së famullitarit në Qëndër, si dhe të drejtën për të pasur

vulën zyrtare dhe të drejtat për të kryer shërbimet fetare si pagëzime, kurorëzime dhe funeralet.

Akordimi nga Kardinali Terence Cooke, Qendrës Katolike Shqiptare i të drejtave kanonike për të kryer të gjitha shërbimet fetare aty, ishte shumë i rëndësishëm pasi me këtë të drejtë, shqiptarët katolikë nuk ishin më të detyruar të shkonin nga një kishë amerikane në tjetrën për nevojat e tyre shpirtërore e fetare, duke emëruar Mons. Zef Oroshin Administrator të Qendrës dhe bashkpuntor të tij Dom Rok Mirditën, i ardhur nga Arqipeshkvia e Tivarit, i cili me entuziazmin e tij sjellë një bashkpunim të zellshëm e të frutshëm duke i dhënë një hov të ri veprimtarisë së Kishës së parë katolike në Amerikë. Por, ndërsa komuniteti i besimtarëve katolikë sa vinte e shtoej gjatë viteve, nevoja për një kishë më të madhe po bëhej më urgjente. Nga shënimet historike mbi jetën dhe veprimtarinë e Lidhjes Katolike Shqiptaro-Amerikane del se meshtarët, në marrëveshje me Këshillin e Kishës vendosën t'i lëshojnë një thirrje të re mbarë popullit të komunitetit shqiptaro-amerikan për një ndihmë të posaçme për të bërë të mundur ndërtimin e një kishë të re, më të madhe, pasi numëri i emigrantëve sa vinte e shtoej sidomos i atyre nga trojet tona në ish-Jugosllavi. Pas lejeve dhe aprovimeve të nevojshme nga autoritetet shtetërore dhe kishare amerikane, më 24 Shtator, 1978 bëhet inaugurimi i kishës së re me një meshë madhështore dhe pjesëmarrje të madhe bashkatdhetarësh nga i mbarë komuniteti shqiptaro-amerikan, me përfaqësues të të gjitha feve dhe nga mbarë viset shqiptare. Nuk ishte këjo një ndërmarrje aspak e lehtë. Në një editorial të gazetës Dielli të asaj kohe,

Kryeredaktori Xhevat Kalljaxhiu përshëndet hapjen e kishës katolike shqiptare në Bronks, si "një vepër me të vërtetë të madhe", dhe uron e përgëzon "iniciatorin e vjetër e kryesor, Monsinjor Zef Oroshin, të Përndershmin Rok Mirditën, këshillat dhe besimtarët, që nuk kursyen prej shumë vjetësh, ndihmën morale dhe materiale për këtë vepër të shenjtë fetare e kombëtare", si "ndërgjegjës të misjonit të tyre jo vetëm si predikues të fjalës së Zotit, por edhe si predikues të Shqiptarizmit e të vëllazërimit midis shqiptarëve", përfundoi editorialin ish-gazetari i njohur i Zërit të Amerikës Xhevat Kalljaxhiu. Në këtë ndërkohë, shqiptarët katolikë të Nju Jorkut kishin ndezur edhe një shkëndi tjetër atë të "Shën Pjetrit e Palit", nën udhëheqjen e meshtarit Dom Lazër Shëldija, e cila në Shkurt të vitit 1987, me miratimin e këshillave dhe të meshtarëve të tyre, Dom Rok Mirdita dhe At Andrew Nargaj ndërmorën vendimin për bashkim historik, në një kishë të përbashkët, kushtuar Pajtores së Shqiptarëve, Zojës së Shkodrës. Ishin përpjekje të vështira këto për të bashkuar shqiptarët e shpërndarë anë e mbanë Nju Jorkut dhe në shtete të tjera. Por me vullnetin e pandërprerë, me sakrificë e mundime të mëdha që vetëm pjesëmarrësit dëshmitarë të asaj periudhe i njohin mirë, Komisioni fillestar dhe komisionet e këshillat e kishës në vazhdim, kapërcyen kundërshtimet, apatitë, ndërhyrjet qëllim-këqia, dhe ia dolën më në fund objektivit të lartë fetar e kombëtar.



NIS RESTAURIMI I KISHËS SË KUVENDIT TË ARBRIT

Me dt. 27 prill 2022, kanë nisur punimet për restaurimin e Kishës së Shën Gjon Kryepremi, apo siç njihet ndryshe Kisha e Kuvendit të Arbrit. Pikërisht në 14 janar 1703 Papa Klementi XI mbledhi në Mërq të Lezhës Kuvendin e Arbrit.

Bëhet e ditur se punimet për krijimin e Qendrës së Kuvendit të Arbrit në Mërq të Lezhës, po zhvillohen në bashkëpunim me Dioqezën e Lezhës, rektorin Dom Martin Jakut dhe studiuesit dom Nikë Ukgjini.

Sipas studiuesit Dom Nikë Ukgjini, projekti është afishuar edhe në ambientet e kishës dhe do të realizohet sipas fotove 3D.


Ukgjini theksoi se punimet do të zhvillohen në tre faza ndërtimi:

Rehabilitimi i Kishës mesjetare të Kuvendit të Arbrit duke e kthyer në identitetin e saj të mëparshëm. Meremetimi i qelës e ndërtuar në vitin 1668 dhe krijimi i një parku artistik në oborrin e Kishës si simbol i Kuvendit të Arbrit. Punimet për momentin janë duke u zhvilluar me ndihmën e sipërmarrësit, Gjergj Lejeqeza, banorëve, që jetojnë në Mërq dhe atyre jashtë vendit.

Ukgjini pohoi gjithashtu se pritet ndihma e Bashkisë së Lezhës si dhe disa mërgimtareve shqiptare, që jetojnë në Evropë dhe Amerikë, për shkak të rëndësisë historike mbarëkombëtare që mbart ky projekt.

Lezha Press.






Stefan Çapaliku
Shtjefën Palushi
Botimet Fishta



At Benedikt Dema
Fjalori
Botimet Françeskane 2021



Camaj
Novela
Onufri 2012

KUMBONA E SË DIELËS
revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult
Tirazhi: 100 kopje
Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)
Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: www.kishakatolikeshkoder.com
Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"
Shtypur në eleven studio - www.11stud.io